

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXVI - Nr. 7835 E premte 29 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Nga JORGJI KOTE

Drejt "Exit" nga Brexit?



Brexit dhe kryeministria britanike May pësuan një disfatë të rëndë politike dhe morale natën e 27 marsit, kur Parlamenti u tha prerazi "Jo" të teta alternativave ...
Vijon në faqen 20

Opinion *i* **Ditës**

Nga REZARTA DELISULA

Për Li Memën, kolosin e futbollit shqiptar...



Nuk mund ta shihja ashtu shtrirë, me fytyrën e zbardhur dhe tiparet e errëta, ndërsa sillja ndër mend vitalitetin e kolosit të futbollit shqiptar, Ali Memën ...
Vijon në faqen 21



Kryemadhi: Do të luftojmë pa u ndalur

Tri orë në protestë, Basha: S'ka tradhti e pakt me Edi Ramën. 23 të ndaluar në polici

Kryeministri nuk "dorëzohet": Zgjedhjet më 30 qershor, Kuvendi vazhdon deri në 2021

Nga VALENTINA MADANI

Për afro tri orë, opozita protestoi dhe përpara parlamentit dhe Ministrisë së Brendshme. Përplasje, tension, lëndë tymuese, tentativa për të çarë kordonin e policisë, këto ishin disa nga momentet që u vunë re në protestën e organizuar nga ...

Në faqet 2-3

SHITBLERJA E SHTEPIVE/ TABELAT ME VLEREN REFERUESE PER METER KATRORE

ÇMIMET E APARTAMENTEVE NE TIRANE DHE NE RRETHE

Vendimi i qeverisë, nuk ndryshon çmimi në zonën e ish-Bllokut, 190 mijë lekë për metër katror. Shtrenjtë Durrësi e Vlora, më të lirët Memaliaj dhe Fushë-Arrëzi



(Në foto) Pallate në Tiranë

Në faqen 7

TABELAT

Rriten pagat e mësuesve të arsimit parauniversitar, të gjitha kategoritë

Në faqen 14

GUVERNATORI I BSH

Gent Sejko: Tensioni politik në Shqipëri mund të ndikojë edhe në ekonomi

Në faqen 6

VENDIMI I GJKATES

Vrasja në Bllok, Apeli i të lirë Ervin Matën, bie kërkesa e prokurorit

Në faqen 8

INTERVISTA

Neritan Liçaj: Politikën në këtë vend e krahasoj me ujin e Lanës

Në faqen 12

ISH-MINISTRI I BRENDSHMEM



Xhafaj kundër Lleshajt: Vetingu 'i ri' në polici çënon besimin te procesi

Në faqen 5

Gjykata lë në burg 3 të dyshuarit. Ngjarja, si u ndoq menaxheri i VIP-ave

SMS para vrasjes: Më thuaj po e pe Jurgen Kurtin

Prokuroria zbardh komunikimet mes të rinjve të arrestuar si bashkëpunëtorë

NGA KLODIANA LALA

TIRANË- Dhjetë ditë pas ekzekutimit të biznesmenit Jurgen Kurti në rrugën "Zef Jubani" në Tiranë, policia ka bërë të mundur zbardhjen e dinamikës së ngjarjes. Pamjet e kamerave të sigurisë si dhe disa me-



sazhe telefonike janë provat e para të forta që implikojnë në krim të arrestuarit, Olsi Qalliaj, Elsi Levendi dhe Alesio Berberi dhe të shumëkërkuarin Klodian Bane (Buxhaku). Në dosjen hetimore të siguruar nga "Gazeta Shqiptare" ...

Në faqen 9

AKSIONI I OPOZITËS PROTESTA

Protesta, kreu i PD-së: Populli do të përgjigjet dhëmb për dhëmb

"Liri a vdekje", Basha mesazh Ramës: Ora e hakmarrjes po afron

"S'do të ketë zgjedhje dhe pakt me Ramën"

Valentina Madani

Lideri i Opozitës Lulzim Basha garanoi dje mbështetësit e shumtë në protestë se as nuk do të bëjë marrëveshje dhe as nuk do të ketë zgjedhje me Edi Ramën kryeministër. Basha akuzoi Ramën se për gjashtë vite ka grabitur shqiptarët duke i varfëruar ata akoma më shumë. Në fjalën e mbajtur përpara protestuesve të opozitës, z.Basha e cilësoi parlamentin si bandën më të keqe të shqiptarëve. Basha deklaroi se Partia Demokratike dhe opozita do të zgjidhin hallet dhe problemet e të gjithë shqiptarëve. Duke iu drejtuar mbështetësve të opozitës, Basha tha se ndryshimi i vendit mund të përbëhet vetëm përmes largimit të qeverisë. "Sot në këtë protestë, me pjesëmarrjen dhe qëndresën tuaj, keni bërë të dëgjohet zëri i shumicës absolute të shqiptarëve, që ka një të qartë dhe të paravokueshëm, Rama ik! Orët e kësaj bande po numërohen mbrapsht me çdo bashkim të jashtëzakonshëm proteste si ky i sotmi. Kush nuk e ka dëgjuar, kush nuk e kuptuar lë ta kuptojë, zgjedhje me Edi Ramën nuk do të ketë. Pakt me Maduron e Ballkanit nuk do të ketë. Kjo betejë ka nisur për të çliruar Shqipërinë nga historia e krimtimit dhe korrupsionit me të thellë që ka njohur Shqipëria në 30 vjet dhe nuk do të ndalet pa e bërë këtë realitet", u shpreh kreu i PD-së. Lulzim Basha përmendi se të gjithë i kemi një turpshëm dhe "antimiting" prezantimin e Erion Velisë si kandidat për kryetar të bashkisë së Tiranës. "Edi Rama disa ditë më parë bëri antimitingun më të turpshëm që nga koha e Ramiz Alisë, kërcënoi artistët me shemb-



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në protestë

DHUNIMI I STUDENTIT

Studenti Gesard Hazizi u dhunua dje gjatë protestës nga forcat Shqiptonja të cilin e dërguan në spital. Ish-deputeti Bardh Spahia vizitoi dje në Spitalin e Traumës. Ai u dërgua me urgjencë në spital pas hematomave të marra nga goditjet e policisë. Studentit të Gazetarisë me mesatare 9.5 mësohet se i është prerë bursa edhe pse është jetim.



Nga protesta e djeshme e opozitës

TË NDALUARIT

Pas protestës së opozitës Policia e Shtetit shoqëroi 23 protestues, të cilët dyshohet se gjatë protestës kanë hedhur mjete piroteknike në drejtim të tyre. Të shoqëruarit mbahen në drejtorinë e Policisë së Tiranës dhe në disa komisariate. Nga ana tjetër, vijojnë verifikimet e të shoqëruarve nga strukturat policore, ndërsa një pjesë e qytetarëve u mbledhën para ambienteve të Policisë së Tiranës duke kundërshtuar veprimet e policisë.

"Rama të vijë të dialogojë me popullin"

Kryemadhi: Djegia e mandateve një meakulpa përballë shqiptarëve

Drejtuësja e LSI, Moni Doka Kryemadhi akuzoi dje kryeministrin Rama se ka futur vendin në varfëri dhe se ka detyruar shqiptarët që të braktisin vendin. Para protestuesve, Kryemadhi tha se shqiptarëve po u mungon buka në tavolina dhe se të gjithë duan që të largohen. Sipas Kryemadhit, qeveria ka dështuar pasi është vendosur në shërbim të bandave. Kryemadhi i kërkoi kryeministrin Rama që të dialogojë me qytetarët e Shqipërisë. "Edi Rama të vijë të dialogojë këtu me popullin. Të dialogojë me ju që paguani fatura dhe taksa pafund. Është e vërtetë që ne gjithë politikantë kemi fajin tonë,



që kemi mbyllur sytë dhe veshët përballë zullumeve të Ramës. Por më mirë vonë sesa kurrë. Më mirë vonë për të shpëtuar të ardhmen e femijëve të shqiptarëve sesa mos ta bëjmë kurrë këtë lëvizje. Djegia e mandateve të opozitës për shumë kush mund të thotë veprim ekstrem, i nxitur etj. Djegia e

mandateve ishte përgjegjësi e plotë e atyre deputetëve që vendosën të jenë njësh me popullin. Djegia e mandateve ishte e vetmja mundësi për të treguar që interesi publik është më i rëndësishëm se interesi i 5 njerëzve që drejtohen nga Rama. Në sot duhet të luftojmë pa u ndaluar, pa bërë asnjë hap pas, por duke ecur përpara për të thënë se fatin shqiptarët e kanë në dorë vetë. Politikantë janë shërbëtorët qytetarëve dhe jo qytetarët shërbëtorë të politikaneve. Në si opozitë kemi shumë për të bërë, janë bërë aq shumë gabime sa që do na duhet të gjithë së bashku ti rregullojmë", tha zj. Kryemadhi.

jen e teatrit dhe të monumenteve të tjera të kulturës. Edi Rama, thirrri mendjes se i ke orët e numëruara dhe kërcënimeve populli do të përgjigjet sy për sy e dhëmb për dhëmb. Nuk trembemi. Nuk tërhiqemi: Liri a vdekje, Demokracia a vdekje!". Nuk ka asnjë shans që populli i bashkuar të lodhet, përçahet e të kthehet në racën e deleve që

ke mbyllur aty. Nëse nuk ka zgjidhje politike monopoli i parë që do të shembet është monopoli i dhunës shtetërore. "Ora e hakmarrjes popullore po afron!" u shpreh kryetari i PD-së duke bërë disa premtime për fermerët, investorët e vegjël, mjekët dhe inxhinierët. Basha u bëri thirrje socialisteve të ndershëm: "Sot i shtrij dorën të gjithë social-

istëve të ndershëmve këtë pakt kombëtar e ndryshim të madh që po vjen atë të Shqipërisë si gjithë Europa dhe paralajmëroj prerë e qartë të gjithë bashkëpunëtorët e regjimit kriminal, me kollare, me kostum me atlete dhe me gojën e dhënë me qira se populli as nuk i harron dhe as nuk i fal shërbimet e klikës mafioze në pushtet".

SHKURTE

Protesta, shkrimtari Erebara: Bashkë kundër diktaturës

I pranishëm në protestë shkrimtari Rudi Erebara, mbështeti qëndrimin e opozitë për mos zhvillimin e zgjedhjeve me qeverinë "Rama", ndërsa bëri thirrje "Rama ik!". "Një vit më parë na quajtën shpellarë ne që mbrojmë Teatrin. Barbarët që duan të shkatërrojnë dhe kanë shkatërruar çdo gjë që kishte kujtesë në këtë qytet dhe në të gjithë Shqipërinë. Barbarët që shkatërruan sheshin "Skënderbej" dhe bënë kodra e fusha. Barbarët që nuk kanë lënë vend pa mbjellë kulla. Barbarët që kanë mbyllur të gjitha institucionet e artit me kryeministrin piktor. Barbarët që shkatërruan çdo strukturë juridike me mund të drejtoheshim, të zgjidhnim problemim tonë të Teatrit. Ky parlament për turp votoi dy herë një ligj special për të shembur historinë e këtij vendi. Ku parlament nuk ekziston më. E mbështes plotësisht qëndrimin tim si shkrimtar dhe qytetar, qëndrimin e opozitës që nuk ka zgjedhje me këtë qeveri. Rama ik!", tha z.Erebara.

LSI, Gjoshë: Për 5 minuta do thyenin kordonin e policisë

Ish-ministria Klajda Gjoshë tha se qëllimi i protestës nuk është dhunimi i institucioneve, por sensibilizimi i qytetarëve se kjo qeveri duhet të largohet. "Protestuesit do të mund ta thyenin kordonin policor për 5 minuta. Por pavarësisht kësaj masa u rregua e përmbajtur, tregoi që nuk e ka revoltën me policinë, me institucionet, por me qeverinë", tha Gjoshë në "News 24". Ajo shtoi më tej se: "Rruga që kemi para e gjatë, përpara kemi një individ jo vetëm arrogant, por edhe me një mentalitet ku nuk ekziston fare mundësia e lënies së zyrës së tij". Gjoshaj u pozicionua qartazi kundër pjesëmarrjes së opozitës në zgjedhjet lokale, ndërsa parashikoi se në kushtet e protestave dhe presionit popullor Rama do të pranojë shumë shpejt zgjedhjet e parakohshme. "Rama shumë shpejt do t'i pranojë zgjedhjet e parakohshme. Kërkesa jonë është për të pasur zgjedhje të parakohshme, që t'i japë fund fenomenit të ndodhur në 2017 të shitblerjes së votës", tha Gjoshë.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Ltaqa Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0680087823-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotrorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Valentina Madani

Për afro tri orë, opozita protestoi dje përpara parlamentit dhe Ministrisë së Brendshme. Përplasje, tension, lëndë tymuese, tentative për të çarë kordonin e policisë, këto ishin disa nga momentet që u vunë re në protestën e organizuar nga opozita në sheshin përpara godinës së parlamentit. Protesta e opozitës nisi me një incident me banorët e "Astirit", të cilët u ndaluan të marshonin drejt parlamentit përmes pedonales, duke sjellë edhe konfrontimin me policinë. Në mes të protestuesve ishin ish-deputetë demokratë, të cilët pas kritikave të kryetarit Lulzim Basha, ishin shpërndarë në çdo vatër proteste dhe në ballë të saj, edhe kur protestuesit tentonin të thyenin kordonin e policisë. Kjo skenë u përsërit herë pas here, ndërsa situata u tensionua më shumë kur fjalën e morën drejtuesit e opozitës. Konfrontim fizik pati mes punonjësve të rendit dhe protestuesve, të cilët tentuan të çanin kordonin e policisë për të shkuar drejt Kuvendit. Fillimisht përplasia nisi përpara Ministrisë së Brendshme, ku protestuesit tentuan të hynin brenda rrethimit të pedonales, teksa pritej mbërritja e ministrit Lleshaj dhe atij të Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës, Ferdinand Grapperhaus. Një tjetër përplasje përpara parlamentit, ku protestuesit hodhën kapsolla e sende të forta në drejtim të policisë dhe tentuan disa herë të çanin kordonin e policisë.

DELEGACIONI

Tensionet e para u shënuan në pedonalen pranë Ministrisë së Brendshme, e cila ishte bllokuar ana e policisë, por banorët e "Unazës së Re" tentuan të kalonin përmes kësaj rruge, për t'iu bashkuar pjesës tjetër të protestuesve përpara parlamentit. Banorët e "Astirit" u përplasën me forcat e policisë para Ministrisë së Brendshme, ku ministri Sandër Lleshaj përgatitej të pristë në takim ministrin e Drejtësisë dhe Sigurisë së Mbrëtërisë së Holandës, Ferdinand Grapperhaus. E njëjta situatë e tensionuar u pa edhe para parlamentit. Policia ishte vendosur kordon, ndërsa disa metra më tutje në gatishmëri ishin dhe forcat speciale. Mëbshtetës të opozitës, por edhe ish-deputetë u përplasën me policinë, sepse duan t'i afrohen parlamentit për të protestuar. Por, policia nuk i lejon dhe ka vendosur kordon mu pranë godinës së KQZ-së. Bulevardi u liria për të kaluar një delegacion nga Holanda, teksa ndërkohë demokratët akuzuan se po u mohohet e drejta e protestës. Policia zgjeroi perimetrin e sigurisë. Një numër i madh efektivash krijuan kordon disa metra larg ministrisë, duke lënë të lirë edhe një pjesë të bulevardit. Po ashtu, policia pati një mobilizim edhe para Kryeministrisë, ku vendosi rrjeta teli për t'i paraprirë një skenari të mundshëm nga ana e protestuesve.

Njolla me bojë të zezë te Ministria e Brendshme, orët e tensionit para Kuvendit

"Rama ik!", opozita 3 orë protestë kundër qeverisë

Policia, thirrje Bardhit: Personat me maska të largohen



PËRPLASJA

Tensionet e para në protestë dje u shënuan në pedonalen pranë Ministrisë së Brendshme, e cila ishte bllokuar ana e policisë, por banorët e "Unazës së Re" tentuan të kalonin përmes kësaj rruge për t'iu bashkuar pjesës tjetër të protestuesve përpara parlamentit.

DEKLARATA

"Prokurorët janë tredhur nga hallatet dhe nuk thërasin asnjëherë zyrtarët. A i keni parë të shkojë aty, Gjinkunri, Dako, Afrim Qendro, Qazim Sejdiu! Ne nuk përdorim dhunë. Nëse ne do të donim, e kapërcenim atë gardh për 2 minuta. Nuk ka gardh që na ndal", tha ish-deputeti Salianji.

PD: Shqipërinë e nxiu Rama, e bëri çerdhe të krimit

Boja mbi Ministrinë e Brendshme, Rama: Opozita synon të nxijë vendin

Kryeministri Edi Rama këndoi gjestin e opozitës për bojën e hedhur mbi institucionin e Ministrisë së Brendshme. Nga foltorja e Kuvendit, Rama e quajti veprimin e protestuesve të opozitës si produktin më të mirë për nxirjen e Shqipërisë në botë. Rama tha se protestuesit hodhën bojë, me qëllim që të ekspotojnë pamjet në drejtim të mediave ndërkombëtare. Duke u ndalur te ligji i vetingut në polici, kreu i qeverisë deklaroi se është bërë një punë e madhe, me qëllim reformimin e policisë. Ai tha se qëllimi i qeverisë është që të kemi një polici në standardet e BE-së. Sipas Ramës, Shqipëria është më e sigurt se



pesë vite më parë, pasi kjo gjë është treguar dhe në uljen e nivelit të krimit në vend. Pas deklaratës së Ramës, reagoi PD-ja. Sekretari i Përgjithshëm i PD, Gazment Bardhi, akuzoi kreun e qeverisë se është ky i fundit, ai që ka nxirë vendin dhe jo opozita. Sipas Bardhit, njollat e zeza mbi ministrinë ishin për Saimir Tahirin, Fatmir Xhafajin, kampionin e përdorimit të Policisë së Shtetit për të mbrojtur vëllain trafikant drogë; 1 për Llesh Kimikun, kampionin e servilizimit, paafzësish dhe korrupsionit! Tik... tak... tik... tak Rama!/#Shqipëria si gjithë Europa", tha z.Bardhi.

"Shqipërinë e ka nxirë Edi Rama duke e kthyer në këto 6 vite në 'bazë operacionale të krimit të organizuar rajonal', pikë kyçe të shpërndarjes së heroinës në të gjithë Europën dhe 'vend kryesor të pastrimit të parave në botë'. Njollat e zeza sot mbi Ministrinë e Brendshme nga qytetarët ishin: 1 për Saimir Tahirin, kampionin e narkoshtetit në Ministrinë e Brendshme; 1 për Fatmir Xhafajin, kampionin e përdorimit të Policisë së Shtetit për të mbrojtur vëllain trafikant drogë; 1 për Llesh Kimikun, kampionin e servilizimit, paafzësish dhe korrupsionit! Tik... tak... tik... tak Rama!/#Shqipëria si gjithë Europa", tha z.Bardhi.

THIRRJA

Policia e Shtetit bëri thirrje për ruajtjen e qetësisë. Në një deklaratë, policia kërkoi nga protestuesit ndërprerjen e veprimeve të dhunshme dhe përdorimin e kapsollave. "Ju lutemi, ruani qetësinë! Ndërpreni veprimet e dhunshme. Mos hidhni kapsolla, lëndë piroteknike dhe sende të forta në drejtim të policisë. Ju bëjmë thirrje të distancoheni nga veprimet e dhunshme. Mos u përplasni me policinë. Veprimet e tubueseve janë në kundërshtim me ligjin. Policia do të zbatojë ligjin. I nderuar zoti Gazmend Bardhi, si organizator i tubimit, merrni masa që personat që hedhin kapsolla, lëndë piroteknike apo sende të for-

ta t'i ndërpresin menjëherë këto veprime. Merrni masa që personat që mbajnë maska në tubim ose t'i heqin, ose të largohen", - bëri thirrje policia. **INCIDENTI** Të gjithë protestuesit u bashkuan në sheshin para parlamentit, ku me pankarta në duar dhe me fjalime të përfaqësuesve opozitarë, e cilësuan parlamentin iligjimit, të mbushur me kriminelë dhe njerëz të pa-përgjegjshëm, që mendojnë se përfaqësojnë popullin. Ndërsa, kryefjala e të gjitha fjalimeve dhe brohoritjeve të kësaj proteste ishte kërkesa për largimin e kryeministrit Rama. Me thirrjet "Rama ik!", protestuesit tentuan të çanin kordonin para Kuvendit. Ish-

deputetë të Partisë Demokratike, Lëvizjes Socialiste për Integritim dhe banorët të zonës së "Astirit" mbajtën fjalime para protestuesve nën zhurmën e shashkave dhe tymueseve. Në parlament vijonte normalisht puna me seancën plenare. Në seancën plenare të kësaj të enjteje u betuan edhe dy deputetë të rinj nga radhët e kandidatëve të opozitës. Kështu, kryetari i Ballit Kombëtar, Adriatik Alimadhi zëvendësoi Agron Shehajn, deputetin e dorëhequr të Partisë Demokratike në Vlorë. Arben Elezi ulet në karrigen e lënë bosh nga Edmond Spaho nga qarkun e Elbasanit. Ambra Borova, e cila do të merrte mandatin e Agron Celës në Shkodër nuk ishte e pran-

ishme në seancën ku parashikohet të bënte betimin. Jashtë Kuvendit, protestuesit tentuan të çanin kordonin e policisë, hodhën shashka dhe tymuese, ndërkohë që përfaqësues të opozitës vazhdonin të mbanin fjalimet. Përpara protestuesve, Lulzim Basha paralajmëroi kryeministrin Rama se nuk ka kthim pas nga beteja e nisur me qytetarët.

MARSHIMI

Pas disa tentativave për të çarë kordonin e policisë dhe në përfundim të fjalimeve të përfaqësuesve opozitarë, protestuesit nisën marshimin në drejtim të Ministrisë së Brendshme. Me një lëvizje të papritur, teksa situata ishte tensionuar, ish-deputeti Flamur Noka u kërkoi protestuesve të ndiqnin z.Basha drejt Ministrisë së Brendshme. Në drejtim të godinës së kësaj ministrie u hodh bojë e zezë, ndërsa protestuesit morën sinjal të tërhiqeshin drejt selisë blu. Protestuesit të kryesuar nga vetë Lulzim Basha u shpërngulën përpara Ministrisë së Brendshme, ku kërkuan lirinë e të arrestuarve gjatë protestave të mëparshme dhe hodhën bojë të zezë në muret e saj. Ata edhe kanë lyer me bojë të zezë një pjesë të fasadës. Pasi ndaluan para Ministrisë së Brendshme dhe qëndruan aty për rreth 20 minuta, protestuesit janë larguar. Mbylljen e protestës, Lulzim Basha e bëri nga selia blu, ku prazri tha se nuk do të ketë pakt e as zgjedhje me Edi Ramën kryeministër. I rrethuar nga ish-ministra e ish-zyrtarë të Partisë Demokratike, para simpatizantëve kërkoi edhe fjalë për qeverisjen e demokratëve, për ata që tha se u pasuruan gjatë kësaj kohe. Dhe në mbyllje, sikundër është kthyer në traditë pas çdo proteste, himni kombëtar; nën zërin e një tenori.

Incidenti, Paloka: Policia dhunoi edhe invalidin

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka, denoncoi dje përmes rrjeteve sociale dhunën e policisë ndaj një shtetasi me aftësi të kufizuara, që protestonte këtë të enjte me flamur kombëtar dhe atë të BE-së para Kuvendit. "Zotëria në foto është Gjergj Cuni, është invalid. Sot, me një dorë mbështetej në patericë dhe në tjetrën mbante flamurin kombëtar dhe atë të BE-së", shkruan Paloka. Ish-deputeti demokrat shprehet më tej se ai vjen në çdo protestë, sepse "kjo qeveri i ka hequr edhe pensionin e invaliditetit, bukën e gojës". "Por për këtë qeveri dhe Edvin Ramën ky është armiku. Nuk mund të jetë ndryshe. Për një qeveri që mbështet dhe mbështetet të krimi dhe oligarkët, 'armiku' janë qytetarët që nuk çojnë dot bukë në shtëpi të fëmijëve të tyre", deklaroi Edi Paloka. Sipas tij, askush nuk duhet të lejojë më që Rama të tërheqë zvarrë qytetarët. "Ka ardhur koha që qytetarët ta heqin zvarrë këtë kryeministër, bashkë me plehrat e tjera rreth tij", mbyll statusin Edi Paloka.

KUVENDI MAZHORANCA

Sulmet fizike të deputetëve ndaj një kolegu tjetër në sallën e parlamentit, siç ishin edhe rastet e qëllimit me vezë apo bërjes me bojë të kryeministrit Edi Rama do të konsiderohen vepra penale dhe do dënohen me burg. Ndërrhyrja e shumicës qeverisëse për të parandaluar akte të tilla nuk do të përfshijë thjesht dhe vetëm Rregulloren e Kuvendit, por edhe Kodin Penal. Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar dje nga foltorja e Kuvendit se krahas ashpërsimit të dënimit kundër policëve apo mjekëve, në Kod do të përfshihet edhe rasti i goditjes për shkak të detyrës të deputetëve apo anëtarëve të qeverisë. "Barbarëve edhe këtu në parlament, jo për sot, jo për mua, jo për ne, por për gjithmonë, nuk mundet deputeti të këtë imunitet në parlament për

Qeveria, masa të forta për aktet e dhunës në Kuvend

Veze dhe bojë kundër kryeministrit, burg për deputetët dhunues



të goditur fizikisht deputetin. Nuk mundet deputeti të këtë imunitet në parlament për t'iu turrur foltorese apo tryezës së qeverisë fizikisht. Edhe kjo duhet të përfshihet në Kodin Penal. Nuk është e

mundur të vazhdohet më kështu. Pa llogaritur zyrtarët e lartë në funksione publike, kryetarët e bashkive, vetë deputetët në rrugë, që nuk mund të jenë të pambrojtur dhe nuk mund të

ndodhë që në rast se gjendet një i verbër që i sulmon fizikisht, i verbri të amnistohet me gjobë", - tha kryeministri Edi Rama. Kjo do të jetë pjesë e një pakete të veçantë që Ministria e Brendshme do të paraqesë në Kuvend, në kuadër të ashpërsimit të veprës "Goditje për shkak të detyrës". "Po ashtu, është nevojë që më shpejt se vonë të vijë në këtë parlament, paketa për të ndërhyrë në Kodin Penal, për t'u dhënë përgjigje disa shtetësimëve serioze, që nga goditja për shkak të detyrës deri tek adresimi i disa boshllëqeve", - tha Rama.



Gjatë seancës së djeshme parlamentare

Kreu i qeverisë ka përjashtuar çdo marrëveshje që cenon mandatin e qeverisë

Rama: PD dhe LSI shyjnë në Kuvend para 2021, vendoret në 30 qershor

"Bashkëpunim vetëm për reformën zgjedhore"

Kryeministri Edi Rama përjashtoi çdo mundësi për të arritur një marrëveshje me opozitën që do të prekte mandatin e qeverisë së tij. Nga foltorja e Kuvendit, ai është treguar i prerë se çdo përpjekje e opozitës për të detyruar mazhorancën që të ndërpresë mandatin nuk do të tolerohet. "Ideja se këtu do ketë ndonjë zhvillim dhe se do bëhet ndonjë përmbyse e rregullave të lojës, apo do bëhet ndonjë kompromis, ku do futet si pjesë e kompromisit mandati që shqiptarët i kanë dhënë Partisë Socialiste për të qeverisur e vetme, pa të tjerë në prehrë deri në vitin 2021, është një ide ngushëlluese për të ridalë prapë të gardhi të enjten tjetër. Por, më shumë se kaq nuk vlen dhe më larg se kaq nuk çon. Është një ide thjesht e vetëm për të ndenjur të gardhi", - tha kryeministri Edi Rama. Gjithashtu, ai përjashtoi edhe mundësinë që PD-ja dhe LSI-ja të rikthehen më në Kuvend para vitit 2021, kur janë edhe zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Sipas tij, PS-ja nuk do të pranojë asnjë zgjidhje që bën kapërcime ligjore. "Këtu në parlament nuk i fut dot ajo ide më ata, para qershorit të vitit 2021", - u shpreh kryeministri. Gjithsesi, ai bëri të ditur se mazhoranca që ai drejton është e hapur për të bashkëpunuar me opozitën, që gjendet jashtë parlamentit për të miratuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor, përfshi këtu edhe testimin e votim-



Kryeministri Edi Rama

it dhe numërimit elektronik, dy kërkesa këto të opozitës. "Ne do të gjejmë rrugën që të ketë një derë edhe për ata. Jo këtu, por një derë në tryezë. Ne jemi gati që atyre, sidoqoftë, meqë kanë vullat e partive akoma për ca kohë t'iu njohim të drejtën e vullës mbi propozimin, t'iu njohim edhe të drejtën e vetos, po të duan, por nuk do presim gjatë. Do

të presim aq sa është e arsyeshme, sepse nuk do të lëmë veten në dorë të gjykimëve subjektive në qershor nga ana e Këshillit Europian, se ata nuk duan të vijnë", - tha gjithashtu Rama. Në rast të kundërt, ai theksoi se mazhoranca do t'i kalojë këto ndryshime me opozitën e re që është krijuar në Kuvend. "Ne thjesht duhet të ecim përpara. Nuk kemi

ZGJEDHJET

"Ata do vazhdojnë në të tyren. Janë të dëshpëruar dhe të pashpresë. E dinë që nuk fitojnë dot me zgjedhje. Gjëja e duhur për Shqipërinë sot është që ata të rrinë në rrugë atje ku janë. Rrugën kanë zgjedhur, në rrugë të rrinë. Ndërsa ne të vazhdojmë në rrugën që kemi marrë përsipër t'i udhëheqim shqiptarët", - tha kryeministri.

ngut për të bërë kalimin e reformës zgjedhore në Kuvend akoma. Ne jemi këtu. Zonjat dhe zotërinjtë që janë në krahun tjetër nuk i kemi zgjedhur ne dhe nuk i kemi sjellë në këtu. I ka sjellë lista e hartuar dhe e firmosur nga doktorja e shkencave horoskopike, Monika Kryemadhi dhe nga artisti Lulzim Basha. Ndërkohë që sot janë këtu, në vendet që iu jep

Kushtetuta dhe ligji", - u shpreh Rama. Ndërkohë që ai edhe një herë u shpreh i vendosur që ta çojë PS-në në zgjedhjet vendore të 30 qershorit, pavarësisht faktit nëse opozita bëhet pjesë e tyre ose jo. "Hyjnë ata në zgjedhje, s'hyjnë ata në zgjedhje, zgjedhjet vendore do të bëhen në afatin e caktuar dhe ne do të marrim përsipër të qeverisim edhe aty, ku ata kanë qeverisur deri më sot dhe do të qeverisim shumë më mirë se ata, edhe për ata që ne nuk na kanë votuar dhe përsëri nuk do vijnë të na votojnë", - theksoi Rama. Kreu i qeverisë gjithashtu u shpreh se sjellja e opozitës e ka burimin vetëm të fakti që ata nuk arrijnë dot të fitojnë pushtetin me votë. "Ata do vazhdojnë në të tyren. Janë të dëshpëruar dhe të pashpresë. E dinë që nuk fitojnë dot me zgjedhje. Gjëja e duhur për Shqipërinë sot është që ata të rrinë në rrugë atje ku janë. Rrugën kanë zgjedhur, në rrugë të rrinë. Ndërsa ne të vazhdojmë në rrugën që kemi marrë përsipër t'i udhëheqim shqiptarët", - tha kryeministri.



Ballë: PD, peng i financimit të dyshimtë me burim rus

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, në fjalën e tij në seancë plenare u ndal gjatë te hetimet e prokurorisë për lobimin e PD-së në SHBA. Nisur pikërisht nga kjo çështje, ai theksoi se është e nevojshme që të forcohet edhe ligji për partitë politike. "Ne duhet të forcojmë edhe një ligj tjetër, atë të financimit të partive. Jemi para një akti të konfirmuar nga të gjitha burimet. PD, partia e idealeve të dhjetorit, që sot është peng i një financimi të dyshimtë me burim rus prej një mln dollarë. Ish-zv. ndihmësi i Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes tha dje qartë se kur opozita dreg mandatat, kjo është toka më pjellore që Rusia të ushqejë më shumë armiqësi në Ballkan. Nuk është e rastësishme që në 16 shkurt e 16 mars të ketë protestë në Podgoricë, Tiranë e Beograd e më tej protesta e 13 prillit në Tiranë të bëhet pasdite. Kështu del përpjekja jonë për një ligj shumë të mirë për financimin e partive politike", - tha Balla. Ai i bëri thirrje prokurorisë të vijojë punën me intensitet për të zbardhur të vërtetën.



Ndryshimet përplasën ish-ministrin me pasardhësin e tij, Sandër Lleshaj. Ndërhyn Rama

Vetingu, Xhafaj: Cenohet paanshmëria dhe besueshmëria e procesit

"Nuk mund të bëhet nga SHÇBA, është në varësi të ministrit"

Kuvendi votoi dje ndryshimet në ligjin për vetingun në Policinë e Shtetit, të cilat kontrollin e figurës së policëve e kalojnë nga një komision i jashtëm i posaçëm tek Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme. Ndryshimet u miratuan me 76 vota pro 6 kundër, 6 abstenim. Ndërmjet deputetëve që abstenuan ishte edhe ish-ministri Fatmir Xhafaj, i cili shprehu kritikë ndaj nismës së paraqitur nga pasardhësi i tij në detyrën e ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj.

DEBATI

Në fakt, ndryshimet prekin thelbin e nismës së votuar me shumë bujë gati 1 vit më parë me nismën e ish-ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Ndaj ky i fundit u shpreh kundër një nisme të tillë ligjore që prekte një ligj që nuk kishte nisur të zbatohet ende. Ai kritikoi ndryshimet në ligjin për vetingun në polici duke u shprehur se këtë kontroll nuk mund ta bëjë SHÇBA. "Dikush mund të thotë se vetingu në polici është paranojë e ish-ministrit të Brendshëm. Policia nuk është pasuri e partive, por shtyllë e shtetit të së drejtës. Vetingu mbetet instrument kyç. Jam i keqardhur që me alibi false nuk u bë i zbatueshëm në kohë, ndërsa për dy vite u futëm në procesin e zbatimit të drejtësi, na duhen dy vite për të bërë efekt një ligj. Gjithsesi më mirë vonë se kurrë, nuk është herezi ndryshimi i një ligji, por në vlerësimin tim personal ndryshimet nuk janë të duhura në disa arsye, mund të cenohet pavarësia e paanshmëria dhe besueshmëria e vetë procesit. Kemi të bëjmë me skanim të veçantë, dhe nuk mund të bëhet nga SHÇBA, në varësi të ministrit. Një nga sukseset e vetingut në drejtësi është se është i besueshëm nga të gjithë", - tha Xhafaj. Gjithashtu, ai sollti në vëmendje se këto ndryshime sjellin vonësë në proces. "Se dyti cenohet cilësia dhe shpejtësia e procesit. SHÇBA-ja nuk ka kapacitet për ta kryer këtë proces. Ti besojmë vetingun e 13 mijë punonjësve një institucioni që ka 100 punonjës vlerësoj se do ta ngadalësojë procesin. Argumenti financiar nuk është i justifikuar, ajo shumë që mendohet se do të kursehet 2 milion euro, është e papërfillshme nga ajo që pritet" - u shpreh Xhafaj. Ndërkohë ministri i Brendshëm Sandër



Ish-ministri Fatmir Xhafaj

XHAFAJ
"Cenohet cilësia dhe shpejtësia e procesit. SHÇBA-ja nuk ka kapacitetet për ta kryer këtë proces. Ti besojmë vetingun e 13 mijë punonjësve një institucioni që ka 100 punonjës vlerësoj se do ta ngadalësojë procesin. Argumenti financiar nuk është i justifikuar, ajo shumë që mendohet se do të kursehet 2 milionë euro, është e papërfillshme nga ajo që pritet"



Policët në moshë do bëhen roje objektesh para se të dalin në pension

Qeveria do të krijojë shumë shpejt një kompani të sigurisë ku do të "akomodohen" të gjithë ata policë që janë të "lodhur" dhe në moshë. Kryeministri Edi Rama duke folur dje në Kuvend i kërkoi ministrit të Brendshëm që të sjellë për miratim në qeveri aktin që mundëson krijimin e një kompanie të sigurisë së Policisë së Shtetit, e cila do të shërbejë për sistemin e të gjithë policëve që janë në moshë dhe që nuk mund t'i përgjigjin fizikisht detyrave të uniformave blu.

"Dua ta sjell edhe këtë, nxitjen, në mos të përditshme, të përjavshme për ministrin e Brendshëm, për të përfunduar një projekt të nisur, që duhet bitisur, për krijim e kompanisë së sigurisë së Policisë së Shtetit, për të dhënë shërbime për objektet e rëndësishme jo të veçantë dhe për të futur në tregun e deformuar dhe jashtë qdo standardit të sigurisë së objekteve, një trupë të re, që do t'i krijojë mundësi shumë prej punonjësve që tanimë janë në një moshë të caktuar dhe nuk kanë më mundësi të na japin atë efikasitet që kërkohet, që të bëjnë një kalim të butë nga dalja nga shërbimi në Policinë e Shtetit, në daljen në pension. Pra, të kenë një periudhë të ndërmjetme, ku të mund të vazhdojnë të punojnë, ku të mund të fitojnë dhe ndërkohë ku të mund të rrisin në mënyrë të ndjeshme cilësinë e shërbimit të sigurisë së objekteve, duke shkurtuar kostot", - tha Rama.

Betohen dy deputetët e tjerë, nis organizimi i grupeve parlamentare

Kuvendit i janë shtuar edhe dy deputetë të rinj duke u çuar në 98 numrin e përgjithshëm të anëtarëve të tij. Adriatik Alimadhi dhe Arben Elezi janë betuar dhe duke u bërë kështu edhe zyrtarisht anëtarë të rinj të Kuvendit të Shqipërisë. Ndërkohë që Ambra Borova, sipas kryetarit të Kuvendit, pritet të betohet në seancën e ardhshme. Nga ana tjetër deputetët e rinj të betuar tashmë kanë nisur edhe organizimin për të krijuar grupet parlamentare. Ata kanë diskutuar mbi drejtimin e grupeve që do krijojnë. Nga demokratët, Rudina Hajdari është emri më i diskutuar për të marrë drejtimin e grupit në parlament. Gjithashtu Lefter Koka kërkoi që edhe grupi i LSI, të drejtohet nga një grua. Propozimi i



deputetit Enver Roshi ishte që grupi të drejtohet nga deputetja Ediola Braha, ndërsa zyrtarizimi pritet të bëhet javën e ardhshme. Ajo që mbetet për t'u parë është se çfarë emri do të mbajnë grupet parlamentare, duke qenë se deputetët e rinj të betuar në seancë janë përjashtuar nga partitë respektive PD dhe LSI, ndonëse vet administrata e Kuvendit i ka ndarë ata në grupet ekzistuese të këtyre dy forcave. Deri më tani deputetët e rinj në Kuvend, nga radhët e LSI janë: Ylli Shehu, Enver Rroshi, Aurora Mara,

Edmond Rushi, Elda Hoti, Edlira Hyseni, Ediola Braha, Ralf Gjoni, Nimet Musaj, Enada Kapllani, Ambra Borova (pritet të betohet seancën e ardhshme). Ndërsa deputetët e rinj nga radhët e PD që kanë marrë tashmë mandatin janë: Majlinda Halilaj, Alban Zeneli, Ligoraq Karamelo, Lefter Maliqi, Adriatik Alimadhi, Arben Elezi. Këto lista pritet të shtohen në vazhdim, pasi të tjerë kandidatë kanë vendosur të marrin mandatin e deputetit. Një prej tyre është Korab Lita, i cili është kandidat në listën e deputetëve të Tiranës. Lita ka dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit të pasurive dhe verifikimit për t'u ulur më pas në sallën e Kuvendit. Mësohet se ai është njëkohsisht edhe nënkryetar i Bashkisë së Kamzës si përfaqësues i PD-së.

Lleshaj mbrojti ndryshimet e paraqitura, ndërsa theksoi se ato e bëjnë procesin më praktik dhe dinamik në të njëjtën kohë. "Qëllimi i ndryshimeve në ligj lidhet me përmirësimin e procesit, bërjen e tij më dinamik dhe përfundim në kohë e duhur. Parashikohet ngritja e një serie punonjësish në strukturën e Ministrisë së Brendshme. Për këtë proces është parashikuar ngritja e komisioneve që do të merren me kryerjen e vetingut në Policinë e Shtetit. Ndryshimet në ligj nuk prekin thelbin e

procesit të vetingut. Një arsye tjetër lidhet me volumin e madh administrativ për realizimin e vetingut në polici, dhe këtij volumi i bashkëhoqërohet një faturre rreth 3 mln \$, si kosto e këtij procesi." - u shpreh Lleshaj.

RAMA

Pjesë e këtij debati mes ish-ministrit dhe ministrit aktual të Brendshëm u bë edhe kryeministri Edi Rama, i cili mbështeti propozimin e ardhur. "Ndryshimet e propozuara reflektojnë një qasje më praktike dhe ngarkojnë strukturën e

brendshme të kontrollit të Policisë së Shtetit për ta çuar deri në fund këtë proces, pasi të kalojë e para në veting, duke bërë kështu dhe një kursim jo të parëndësishëm, që na krijon më shumë hapësirë buxhetore për të vazhduar të mbështesim Policinë e Shtetit", - tha Rama. Ligji i miratuar parashikon që vetingun për gjithë policët me grada madhore dhe SHÇBA-ja ta kryejë një komision i jashtëm, ndërsa pas këtij procesi SHÇBA-ja do kryejë vetingun e gjithë policëve të tjerë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbartimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbartese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë :
1- Njësi, me sipërfaqe 64.10 m², e ndodhur në Lagjia Barikade, Berat, në Zonën Kadastrale 8501, Numri i Pasurisë: 8/147-N1. Vol. 22, Faqe, 87, në pronësi të Dorjana Gjoroveni, Endrit Gjoroveni, Beshir Gjoroveni. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 4,953,648 (kater milion e nentëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) LEKE.
Ankandi i dytë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 19.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përmbartëse gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Mystym Shyri, vila nr.87, kt.4, Tiranë, nr.kontakti 0699381883.

BANKA E SHQIPERISE POLITIKA MONETARE

Gent Sejko: Rritje e kreditimit në sektorin bankar dhe në investimet private

Guvernatori i BSH: Tensionet politike në vend mund të ndikojnë edhe në ekonomi

"Zhvendosje e pritshmërive jashtë skenarit bazë"

Voltiza Duro

Gjatë dy muajve të parë të 2019-ës, inflacioni ka pësuar rënie duke shkuar në nivelin rënie 1,8%, pavarësisht se nuk është përmbushur objektivi që Banka e Shqipërisë ka pasur për këtë vit. Kjo është bërë me dije nga guvernatori i BSH-së, Gent Sejko në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare. "Në përputhje me pritjet tona, inflacioni në vend pësoi rënie gjatë dy muajve të parë të vitit 2019. Inflacioni mesatar i kësaj periudhe shënoi vlerën 1,8%, duke pasqyruar përcjelljen më të plotë të efektit frenues të forcimit të kursit të këmbimit. Sipas vlerësimeve tona, ky efekt do të kulmojë gjatë gjysmës së parë të vitit 2019 dhe do të shuhet gradualisht gjatë tremujorëve në vazhdim. Paralelisht me këtë efekt, presionet e brendshme inflacioniste paraqiten ende të pamjaftueshme për kthimin e inflacionit në objektivi. Ndonëse zgjerimi i vazhduar i kërkesës agregate ka sjellë rritje të punësimit dhe të pagave, kostot e prodhimit dhe normat e fitimit nuk janë ende të mjaftueshme për të përmbushur objektivin tonë të inflacionit", tha Sejko.

GJENDJA EKONOMIKE

Sipas guvernatorit, situata e tensionuar politike në Shqipëri mund të ketë ndikim edhe në ekonomi. "Paralelisht me rikoni-



Guvernatori i BSH-së,
Gent Sejko

firmin e skenarit bazë të pritjeve, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se rreziqet e kahut të poshtëm janë forcur gjatë vitit 2019. Përkeqësimi i ambientit të huaj, situata e tensionuar politike në vend, si dhe përputhshmëria në kohë e ritmit të përmirësimit të ofertës me atë të kërkesës për kredi, janë faktorë të cilët mund t'i zhvendosin zhvillimet ekonomike poshtë pritjeve të skenarit bazë", theksoi Guvernatori gjatë

konferencës. Ky i fundit shtoi se sipas të dhënave të tërthorta të disponuara, ritmi i rritjes ekonomike duket të jetë ngadalësuar disa gjatë dy tremujorëve të fundit dhe në një masë të madhe, ky ngadalësim pasqyron ecurinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe, si i tillë, nuk vlerësohet se do të ndikojë trendet afatmesme të rritjes.

SEKTORI BANKAR

Gent Sejko u ndal edhe në sektorin bankar ku vuri në



dukje rritjen e kreditimit. "Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është mbështetur nga - dhe pasqyruar në - trendin gradual rritës të kreditit për sektorin privat. Duke përjashtuar efektin kontabël të kursit të këmbimit si dhe atë të nxjerrjes së kredive të humbura jashtë bilanceve, kredia për sektorin privat shënoi një rritje vjetore prej rreth 6% gjatë dy muajve të parë të vitit 2019. Kjo rritje, ndonëse ende

e moderuar, përbën një signal pozitiv për gjallërimin e kërkesës dhe përmirësimin e ofertës për kredi", tha Sejko.

RITJEA EKSPORTEVE

Guvernatori tha se konsumi dhe investimet private kanë vijuar të shënojnë rritje në këtë periudhë, duke pasqyruar përmirësimin e të ardhurave të disponueshme dhe të bilanceve financiare, rritjen e shkallës së shfrytë-

zimit të kapaciteteve, dhe kushtet e favorshme të financimit. "Eksportet shqiptare të mallrave kanë shënuar rritje në tremujorin e katërt të vitit të shkuar dhe ngadalësim në dy muajt e parë të vitit 2019. Ky ngadalësim pasqyroi efektin bazë të eksportit të lartë të energjisë elektrike gjatë së njëjtes periudhë të vitit të shkuar, si dhe koniunkturën jo të favorshme ndërkombëtare për disa kategori të eksporteve tona. Së fundi, politika fiskale ka ruajtur qëndrimin e saj konsolidues, edhe gjatë dy muajve të parë të vitit 2019. Rritja e konsumit, investimeve dhe eksporteve, do të mundësojë zgjerimin e mëtejshëm të punësimit, rritjen e pagave dhe të normave të fitimit, si dhe forcimin gradual të presioneve të brendshme inflacioniste. Paralelisht edhe me shuarjen e plotë të efektit frenues të kursit të këmbimit, këto zhvillime do të mundësojnë kthimin e inflacionit në objektivi brenda vitit 2020", bëri me dije guvernatori i Bankës së Shqipërisë. Më tej, ai tha se edhe kursi i këmbimit paraqitet i qëndrueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 6,800,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 23 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,400,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 18 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Tabela me vlerat mesatare referuese të shitblerjes së shtëpive në Tirane dhe rrethe

Ndryshojnë çmimet për taksën e banesës, ja sa do tatohe mi

Qeveria miraton tarifrat e reja për rrethet dhe komunat e Tiranës

VENDIMI

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve dhe Bashkisë së Tiranës u vendosën dhe janë botuar në Fletoren Zyrtare. Qyteti i Durrësit do të tatohet më shumë se të tjerat me vlerë 67 500,00 lekë për metër katrorë, ndërsa pas tij renditet Vlora me 61 800,00 lekë.

shitblerjen e shtëpive i takon sipërfaqe të shfrytëzueshme. zonës 2/1 dhe shkon 187 Më poshtë janë tabelat për 000,00 lekë metri katror për të gjitha qarqet.

Përcaktohet vlera e tak sushme e shtëpive në rrethe dhe komunat e Tiranës. Me vendim të Këshillit të Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë u vendos ndryshimi i vendimit nr. 132, datë 7.3.2018. Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve dhe Bashkisë së Tiranës u vendosën dhe janë botuar në Fletoren Zyrtare. Qyteti i Durrësit do të tatohet më shumë se të tjerat me vlerë 67 500,00 lekë për metër katrorë, ndërsa pas tij renditet Vlora me 61 800,00 lekë. Në Bashkinë e Tiranës çmimi më i lartë referues për

ÇMIMET PËR TAKSËN E BANESËS

Nr. r. qarkut	Qarku	Nr. r. bashki	Bashkia	Nr. r. qytete	Nr. r. qytet i qarkut	Qytetet	Lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1	Berat	1	Berat	1	1	Berat	41 400,00 lekë
		2	Polican	2	2	Polican	26 000,00 lekë
		3	Uta Vaigurore	3	3	Uta Vaigurore	37 000,00 lekë
		4	Kaçovë	4	4	Kaçovë	36 000,00 lekë
		5	Skrapar	5	5	Çorovodë	25 000,00 lekë
2	Dibër	6	Dibër	6	1	Peshkopi	49 000,00 lekë
		7	Mat	7	2	Burrel	44 300,00 lekë
		8	Klos	8	3	Klos	32 000,00 lekë
		9	Bulqizë	9	4	Bulqizë	41 800,00 lekë
3	Durrës	10	Durrës	10	1	Durrës	67 500,00 lekë
		11	Shijak	11	2	Shijak	41 000,00 lekë
		12	Krujë	12	3	Krujë	48 500,00 lekë
4	Elbasan			13	4	Pushë Krujë	51 000,00 lekë
		13	Elbasan	14	1	Elbasan	50 300,00 lekë
		14	Belsh	15	2	Belsh	35 000,00 lekë
		15	Cërrik	16	3	Cërrik	38 300,00 lekë
		16	Peqin	17	4	Peqin	39 000,00 lekë
		17	Librazhd	18	5	Librazhd	44 000,00 lekë
		18	Përrenjas	19	6	Përrenjas	41 780,00 lekë
5	Fier	19	Gramsh	20	7	Gramsh	43 000,00 lekë
		20	Fier	21	1	Fier	53 100,00 lekë
		21	Patos	22	2	Patos	28 000,00 lekë
		22	Roskovec	23	3	Roskovec	30 000,00 lekë
		23	Lushnjë	24	4	Lushnjë	40 100,00 lekë
		24	Divjakë	25	5	Divjakë	40 100,00 lekë
		25	Mallakastër	26	6	Ballsh	30 000,00 lekë
		26	Gjirokastrë	27	1	Gjirokastrë	47 400,00 lekë
		27	Dropull	28	2	Sofranikë	27 000,00 lekë
		28	Libohovë	29	3	Libohovë	27 000,00 lekë
6	Gjirokastrë	29	Përmet	30	4	Përmet	37 000,00 lekë
		30	Këlcyrë	31	5	Këlcyrë	24 600,00 lekë
		31	Tepelenë	32	6	Tepelenë	32 500,00 lekë
		32	Memaliaj	33	7	Memaliaj	15 000,00 lekë
		33	Korçë	34	1	Korçë	45 800,00 lekë
		34	Maliq	35	2	Maliq	27 800,00 lekë
		35	Pustec	36	3	Pustec	35 000,00 lekë
		36	Devoll	37	4	Balisht	35 000,00 lekë
7	Korçë	37	Pogradec	38	5	Pogradec	49 900,00 lekë
		38	Kolonjë	39	6	Ersekë	23 000,00 lekë
		39	Has	40	7	Leskovik	21 000,00 lekë
		40	Kukës	41	1	Krumë	24 500,00 lekë
8	Kukës	41	Kukës	42	2	Kukës	54 000,00 lekë
		42	Tropojë	43	3	Bajram Curri	27 900,00 lekë
9	Lezhë	43	Lezhë	44	1	Lezhë	56 000,00 lekë
		44	Kurbini	45	2	Shëngjin	56 000,00 lekë
		45	Milot	46	3	Laç	42 500,00 lekë
		46	Mirditë	47	4	Milot	34 000,00 lekë
10	Shkodër	47	Delvinë	48	5	Rrëshen	42 000,00 lekë
		48	Shkodër	49	6	Shkodër	29 500,00 lekë
		49	Vau i Dejës	50	1	Shkodër	58 000,00 lekë
		50	Malësi e Madhe	51	2	Vau i Dejës	24 300,00 lekë
		51	Pukë	52	3	Koplik	40 500,00 lekë
		52	Pushë Arës	53	4	Pukë	22 000,00 lekë
		53	Kavajë	54	5	Pushë Arës	7 500,00 lekë
		54	Rrogozhinë	55	1	Kavajë	51 000,00 lekë
		55	Vorë	56	2	Rrogozhinë	41 000,00 lekë
		56	Kamzë	57	3	Vorë	51 500,00 lekë
11	Tiranë	57	Kamzë	58	4	Kamzë	52 000,00 lekë
		58	Sarandë	59	1	Sarandë	56 000,00 lekë
		59	Konispol	60	2	Konispol	28 000,00 lekë
		60	Pirë	61	3	Livadhja	28 000,00 lekë
12	Vlorë	61	Vlorë	62	4	Vlorë	61 800,00 lekë
		62	Orkum	63	5	Orkum	60 000,00 lekë
		63	Himarë	64	6	Himarë	58 000,00 lekë
		64	Selenicë	65	7	Selenicë	25 000,00 lekë
		65	Delvinë	66	8	Delvinë	26 750,00 lekë
		66	Delvinë	67	8	Delvinë	26 750,00 lekë

a.2) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Tiranë:

Bashkia Tiranë	Nr. i njësisë administrative	Nr. rendor	Zona	Lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi
Qyteti Tiranë sipas ndarjeve zonale për çdo njësi administrative	1	1	1/1	97 700,00 lekë
		2	1/2	78 000,00 lekë
		3	2/1	187 000,00 lekë
	2	4	2/2	134 500,00 lekë
		5	2/3	95 000,00 lekë
		6	2/4	110 000,00 lekë
	3	7	2/5	80 000,00 lekë
		8	3/1	77 000,00 lekë
		9	3/2	60 000,00 lekë
	4	10	4/1	70 000,00 lekë
		11	4/2	60 000,00 lekë
	5	12	5/1	190 000,00 lekë
		13	5/2	132 000,00 lekë
		14	5/3	107 000,00 lekë
	6	15	5/4	82 000,00 lekë
		16	6	65 000,00 lekë
		17	7/1	120 000,00 lekë
	7	18	7/2	100 000,00 lekë
		19	7/3	85 000,00 lekë
		20	7/4	65 000,00 lekë
	8	21	8/1	110 000,00 lekë
		22	8/2	100 000,00 lekë
		23	8/3	72 000,00 lekë
	9	24	9/1	130 000,00 lekë
		25	9/2	100 000,00 lekë
		26	9/3	77 000,00 lekë

Nr. r. qarkut	Qarku	Nr. r. bashki	Bashkia	Nr. r. qytete	Nr. r. qytet i qarkut	Qytetet	Lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi	
10	Njësitë administrative Bashkia Tiranë	27		10/1			145 000,00 lekë	
		28		10/2			139 500,00 lekë	
		29		10/3			102 000,00 lekë	
		30		11/1			87 000,00 lekë	
		31		11/2			75 000,00 lekë	
		32		11/3			70 000,00 lekë	
		33	Baldushk					32 000,00 lekë
		34	Bërzhitë					34 000,00 lekë
		35	Dajt					53 500,00 lekë
		36	Parkë					66 500,00 lekë
		37	Kashar					53 500,00 lekë
		38	Kërnabë					28 200,00 lekë
		39	Ndroq					34 000,00 lekë
		40	Petrelë					53 500,00 lekë
		41	Pezë					53 500,00 lekë
		42	Shëngjergj					23 000,00 lekë
		43	Vaqarr					34 000,00 lekë
		44	Zall-Bastar					25 000,00 lekë
		45	Zall-Herr					28 200,00 lekë

Ngjarja në lokalin "Monopol", ende në kërkim komando Merviol Bilo e Eldi Dizdari

Masakra me 1 të vrarë e 2 të plagosur në ish-Blok, Apeli lë të lirë Ervin Matën

Gjykata rrëzoi prokurorinë që kërkoi lënien në burg të biznesmenit 32-vjeçar

TIRANË

Gjykata Apelit Tiranë dje la në fuqi masën e sigurisë "Detyrim paraqitje" për biznesmenin Ervin Mata, cili është një prej personave të përfshirë në ngjarjen e 5 tetorit në zonën e ish-Blokut ku mbeti i vrarë 28-vjeçari Fabjol Gaxha si dhe u plagosën dy të tjerë. Mata u vetëdorëzua rreth një muaj më parë, ndërsa u la i lirë nga Shkalla e Parë, masë që u konfirmuar ditën e djeshme dhe nga Apeli. Prokurorët e çështjes ankimuan vendimin e dhënë para dy javësh, duke kërkuar burg për 32-vjeçarin. Ndërkohë që Apeli rrëzoi kërkesën e organit të akuzës, duke e lënë në detyrim paraqitje

KËRKESA DHE LIRIMI

Më 14 mars, Ervin Mata iu drejtua prokurorisë së Tiranës me një memo, përmes të cilës kërkoi të japë shpjegime për ngjarjen e ndodhur në tetor të vitit që shkoi në lokal "Monopol. Memo iu është dorëzuar dy prokurorëve të çështjes nga avokati mbrojtës, Alban Bengasi, pasi biznesmeni Mata, ndaj të cilit rëndon akuza e vrasjes kryer në bashkëpunim, nuk ka dhënë deri më tani shpjegime për ngjarjen. Burime nga prokuroria thanë se e kanë administruar kërkesën e Matës dhe se ai do të thirrej ditën e djeshme për të dhënë versionin e tij për krimin, ku viktimë mbeti Fabian Gaxha, dhe u plagosën biznesmeni Ervin Martinaj e miku i tij Eljo Hato. Mbi 32-vjeçarin Ervin Mata janë ngritur akuzat e vrasjes së mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje. Ai do vazhdojë të hetohet për përfshirjen ose jo në vrasjen e Gaxhës dhe plagosjen e Martinajt. Megjithatë, gjatë hetimeve ai nuk do të qëndrojë më në burg. Prokurorët e dosjes ankimuan vendimin në Gjykatën e Apelit, ku kërkuan sërish "Arrest me burg" për 32-vjeçarin. Por dje Gjykata Apelit rrëzoi kërkesën e Prokurorisë, duke e lënë në detyrim paraqitje. Në dëshminë që ka dhënë në policinë e Tiranës pas vetëdorëzimit, Ervin Mata është shprehur se është larguar sapo kanë nisur të shtënë dhe nuk e ka parë se kush ka qëlluar. Ai ka deklaruar përpara hetuesve se nuk është përfshirë në për-



Ervin Mata

plasjen me armë, nga e cila mbeti i vrarë Fabian Gaxha dhe u plagosën Eljon Hato dhe Ervis Martinaj.

PERSONAT NË KËRKIM

Në lidhje me ngjarjen e rëndë që ndodhi vitin e kaluar në zonën e ish-Blokut, aktualisht janë të shpallur në kërkim vetëm dy persona, Merviol Bilo dhe Eldi Dizdari. Komandoja Mevjol Bilo, sipas dosjes së prokurorisë është personi që ka qëlluar me armë zjarri duke lënë të vrarë Fabian Gaxhën dhe plagosur Ervis Martinajn dhe Eljon Haton.

Ndërsa biznesmeni Eldi Dizdari ishte identifikuar nga grupi hetimor disa ditë pas ngjarjes, por vetëm në mesin e muajit nëntor prokuroria ka urdhëruar ndalimin e tij për rrjedhojë, policia e ka shpallur në kërkim, pasi nuk e ka gjetur në banesë. Oficerët që kanë kryer verifikimet në kuadër të hetimit për vrasjen e ndodhur më 4 tetor tek ish-Blok, kanë siguruar të dhëna që flasin për një krisje marrëdhënies mes Ervin Matës dhe Eldi Dizdarit. Në dosjen e prokurorisë shpjegohen veprimet hetimore dhe e gjithë dinamika e ngjarjes. Aty theksohet se para vrasjes, para lokalit të Redi Popeskut kishte pasur një konflikt, në kohën kur Elvana Gjata kishte shkuar të takonte të fejuarin e saj Ervin Mata. Bëhej fjalë për disa persona që ndodheshin brenda një automjeti, i cili kishte ndaluar paralel me makinën e këngëtares, për drejtuesin e së cilës, Ervin Mata ishte shprehur se ishte mik i tij.

AKUZAT

Mbi 32-vjeçarin Ervin Mata janë ngritur akuzat e vrasjes së mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje. Ai do vazhdojë të hetohet për përfshirjen ose jo në vrasjen e Gaxhës dhe plagosjen e Martinajt. Megjithatë, gjatë hetimeve ai nuk do të qëndrojë më në burg. Prokurorët e dosjes ankimuan vendimin në Gjykatën e Apelit, ku kërkuan sërish "Arrest me burg" për 32-vjeçarin. Por dje Gjykata Apelit rrëzoi kërkesën e Prokurorisë, duke e lënë në detyrim paraqitje.

DËSHMIA E BIZNESMENIT

Në dëshminë që ka dhënë në policinë e Tiranës pas vetëdorëzimit, Ervin Mata është shprehur se është larguar sapo kanë nisur të shtënë dhe nuk e ka parë se kush ka qëlluar. Ai ka deklaruar përpara hetuesve se nuk është përfshirë në përplasjen me armë, nga e cila mbeti i vrarë Fabian Gaxha dhe u plagosën Eljon Hato dhe Ervis Martinaj.



British American Tobacco Albania sh.p.k.

Njofton se duke filluar nga data 1 prill 2019, cmimet maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

Nr	MARKA	Cmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë
1	Dunhill FC 7 mg	330
2	Dunhill FC 4 mg	330
3	Kent HD Neo	300
4	Kent HD Infina	300
5	Kent Nanotek (Infina)	300
6	Lucky Strike NFF King Size 6 mg	250
7	Lucky Strike NFF King Size 4 mg	250
8	Lucky Strike Double Capsule Wild	250
9	Lucky Strike NFF Demislims 6 mg	230
10	Lucky Strike NFF Demislims 4 mg	230
11	Rothmans Leggera	250
12	Rothmans of London (Blue)	220
13	Rothmans of London (Sky Blue)	220
14	Rothmans of London Demi 6mg	200
15	Rothmans of London Demi 4mg	200
16	Eva Slims	200

*Cmimet shprehen në Lek

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

British American Tobacco Albania sh.p.k.
Tirane, Rr:"Kavajes", ish Kombinati Ushqimor
web: www.bat.com
office phone: +355 (0) 42 255084

SHKURT

Sherr me thika, plagoset futbollisti 21-vjeçar

TIRANË - Një sherr për motive të dobëta në Institut'ka përfunduar me plagosjen e një të ritu. Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur pasditën e djeshme në rrugën "Taulantët". Mësohet se i plagosur në këtë sherr ka mbetur 21-vjeçari Olsi Meraj, i cili mësohet të jetë futbollist. Sipas burimeve policore, përplasja mes të rinjve ka nisur për një konflikt që shoku i të plagosurit kishte pasur me një grup tjetër. I plagosuri së bashku me shokun e tij po bënin stërvitje në kohën kur janë afuar një grup tjetër djemsh, të cilët janë përleshur e për pasojë ka mbetur i plagosur 21-vjeçari, i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Ndërkaq, blutë po punojnë për kapjen e autorit të krimit.

Tritol makinës së parkuar në oborrin e shtëpisë

FUSHË KRUIË - Rikthehen shpërthimet me tritol në Fushë-Kruië. Një shpërthim i fuqishëm eksploziv ka ndodhur në mesnatë në lagjen 'Hasan' të këtij qyteti. Mësohet se lënda plasëse i është vënë një makine të parkuar në oborrin e shtëpisë të shtetasit Afrim Çekut, i cili sipas policisë nuk raportohet të ketë konflikte me njeri. Fatmirësisht nga shpërthimi nuk raportohet për të lënduar, por vetëm për dëme materiale. "Më datë 27.03.2019, rreth orës 23:10, në fshatin Hasan, Fushë Kruië, në automjetin e shtetasit A.C., të cilin e kishte parkuar në oborrin e banesës së tij, është vendosur një sasi lënde e dyshuar plasëse, e cila ka shpërthyer dhe si pasojë ka vetëm dëme materiale. Grupi hetimor vijon punën për zbardhjen e ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve", njoftoi policia.

Vëllezërit dhunuan mjekun, 1

në pranga, tjetri në kërkim

DIBRËR - Policia e Dibrës ka arrestuar një 43-vjeçar, i cili së bashku me vëllain e tij ka dhunuar një mjek mbremë dhe e së mërkurës. Ndërsa, u shpall në kërkim vëllai i të arrestuarit si person i përfshirë në dhunën ndaj mjekut në kohën që po kryente shërbimin. Sipas bluve, i arrestuari është shtetasi A.L., ndërsa mjeku i dhunuar është Agron Mezexhiu. Mjeku 70-vjeçar kishte shkuar nga Tirana për të kryer shërbimet mjekësore në spitalin e Dibrës, por ra pre e dhunës. Ky rast nuk është i izoluar pasi dhuna ndaj bluzave të bardha ka qenë prezente në Tiranë, Lezhë, Durrës dhe së fundi në qytetin e Dibrës. Të ndodhur përballë këtyre rrethanave, ka qenë vetë kryeministri Edi Rama, i cili tha se do të ndërhyhet në Kodin Penal për të ashpërsuar masat ndaj agresorëve, të cilët godasin mjekët për shkak të detyrës.

Gjykata i lë në burg, 3 të arrestuarit mohojnë të kenë lidhje me ekzekutimin e ish-menaxherit të VIP-ve

"Doli një person, s'jam i sigurt nëse është Jurgen Kurti"

Zbardhet dinamika e vrasjes, si e ndoqën autorët këmba-këmbës viktimën

Klodiana Lala

TIRANË

Dhjetë ditë pas ekzekutimit të biznesmit Jurgen Kurti në rrugën "Zef Jubani" në Tiranë, policia ka bërë të mundur zbardhjen e dinamikës së ngjarjes. Pamjet e kamerave të sigurisë si dhe disa mesazhe telefonike janë provat e para të forta që implikojnë në krim të arrestuarit, Olsi Qalliaj, Elsi Leventi dhe Alesio Berberi dhe të shumëkërkuarin Klodian Bane (Buxhaku). Në dosjen hetimore të siguruar nga "Gazeta Shqiptare" zbardhen të gjitha lëvizjet e të dyshuarve para dhe pas ngjarjes dhe provat që i implikojnë në krim, ndërsa nuk del i qartë motivi se përse është ekzekutuar Kurti dhe kush ishte porositi, pasi dyshimet janë për një vrasje me pagesë. Ndërkaq, ditën e djeshme, Gjykata e Tiranës la në "Arrest me burg" tre të arrestuarit për vrasjen e Jurgen Kurtit. Ata akuzohen për veprat penale "Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim", "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake" dhe "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike". Në seancën e zhvilluar me detyr të mbyllur me kërkesë të prokurorisë për shkak të sekretit hetimor, togat e zeza e vlerësuan ligjshëm arrestimin e tyre. Elsi Leventi, Alesio Berberi dhe Olsi Qalliaj, para gjykatës kanë mohuar të kenë lidhje me vrasjen e aq më tepër bashkëpunimin mes tyre. Ndryshe sa kish deklaruar në polici. Elsi Leventi duke shpjeguar skemën e vrasjes dhe ndjekjes së Jurgen Kurtit, para togave të zeza ai është shprehur se rrefëmi i tij është i manipuluar dhe ai është dhunuar në qeli. "S'kam lidhje me vrasjen, deklarimet më janë marrë nën presion me një avokat që nuk e kam zgjedhur unë dhe nuk e njoh. Por, unë nuk kam lidhje me vrasjen e nuk i njoh të ndaluarit apo personin në kërkim", - është shprehur Leventi para trupit gjyqësor. Ndërsa Qalliaj e Berberi kanë heshtur duke dhënë vetëm gjeneratet e tyre.



Viktima Jurgen Kurti



Arrestuari, Olsi Qalliaj

alitetet e tyre. **DINAMIKA E NGJARJES**

Pas ekzekutimit të 26-vjeçarit Jurgen Kurti, hetuesit u vunë në ndjekje të një makine tip "Mercedes Benz E Clas", ngjyrë gri, e cila u përdorur nga autorët për t'u larguar nga vendngjarja. Kamerat e sigurisë në zonë kishin fiksur makinën në fjalë, e cila kishte disa karakteristika dalluese: kishte një antenë në pjesën qendrore të xhamit të pasmë dhe kur frenonte, drita e frenës tek pjesa e bagazhit nuk ndizej plotësisht. Dyshimet janë shtuar për faktin se automjeti është fokusuar për herë të parë rreth orës 20:00,

teksa hyn kundravajtje pikërisht në vendin ku dy orë më vonë, u vra Kurti dhe bënë tri xhiro. Nga aty del tek posta nr:8 më pas në rrugën "Sulejman Delvina". Targa e mjetit rezultonte e vjedhur. Referuar pamjeve, automjeti që më vonë rezultoi të ishte në pronësi të Klodian Banes, shkoi tek vendi i ngjarjes dhe ndalon për rreth një orë. Drejtuesi del disa herë dhe shfaqet tek fotografat shkallët e pallatit të Jurgen Kurtit. Elsi Leventi i ndërkohë dallohet që vjen nga posta dhe ulet tek kafja ngjitur me hyrjen e një palestere, në të cilën ndodhej Kurti. Katër orë më parë, ai kishte marrë porosi me me-

Fqinjët: Jemi shokuar, Olsi, nga djemtë më të mirë të lagjes

Flet nëna e Qalliajt: Nuk e besoj që im bir ka bërë vrasje, e vërteta do të dalë në shesh

FIER - Jashtë kamerave, nëna e Olsi Qalliaj, i cili u arrestua si një nga personat e dyshuar të vrasjes së Jurgen Kurtit në Tiranë, ka folur për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare", ndërsa shprehet dhe ka besim të djali i saj se nuk është përfshirë në një ngjarje të tillë. Ajo tha se të gjitha informacionet e publikuara deri më tani nuk janë aspak të vërteta se djali i saj ka makina të shtrenjta dhe biznese. "Djali nuk kishte punë. Olsi merrej me shitje makinash, i punësuar. Kohët e fundit ka qenë pa punë. Nuk ka makinë. Nuk ka biznes. Nuk ka asgjë. Baba është në emigracion. Shtëpitë janë të papërfunduara. Kemi një dyqan të vogël, me të cilin ushqehemi. Nuk e besoj që djali ka bërë këtë gjë. E vërteta do të dalë në shesh. Ato që kanë dalë janë një skandal. Ka një xhaxha në Itali. Një në Amerikë. Kemi vjehrrën dhe vjehrrën në shtëpi. Nuk është gjetur asnjë armë në shtëpi. Unë jam e papunë. Osi nuk ka një makinë. Ato që dalin nuk janë të vërteta. Nëse Osi do kishte aq lekë, do ishte



Fqinji i Qalliajt duke folur për "GSH"

mbushur me makina këtu jo me dru për t'u ngrohur në sobë", u shpreh nëna e Olsi Qalliaj. Gjithashtu, edhe të afërmit e Olsi shprehen të shokuar për këtë rast. Ata besojnë se Olsi nuk është i përfshirë në këtë ngjarje si dhe kanë besim se drejtësia do të japë drejtësi. Fqinjët e të riut tregojnë mes tjerash se Olsi Qalliaj është një nga djemtë më të mirë të lagjes, por nuk të përjashtojnë mundësinë se ai mund të ketë rënë viktimë e shoqërisë. Nga ana tjetër vijnë hetimet intensive për zbardhjen e plotë të ngjarjes së rëndë, ku Jurgen Kurti apo i njohur ndryshe si "Menaxheri i VIP-ve" mbeti i vranë ditë më parë në kryeqytet. "Jemi shumë të

shokuar për ngjarjen. Olsi është një nga djemtë më të mirë të fisit tonë dhe ne jemi shumë të shokuar. Mendoj se mund të jetë edhe viktimë e shoqërisë. Është djali më i miri i lagjes, është rritur me djalin tim, ndërsa sot djali im është për doktor, por Olsi nuk kishte mundësinë të vijonte me tej. Familja e Olsit është hallexhije siç jemi të tërë ne, por të kishte Olsi atë jetë luksoze siç ka dalë në media, ai do ta kishte rregulluar katin e dytë të shtëpisë. Drejtësia do të bëjë drejtësi dhe Olsi do të dalë i pafajshme, sepse nuk është djali i tillë", thanë mes tjerash fqinjët.

sazh që të mbante nën vëzhgim Jurgen Kurtin. "Kalo pak tek lagja mbraja postës dhe shiko Jurgen Kurtin. Më thuaj nëse e sheh këtë person". Leventi shkruan se nuk e njohte personin, por i ka ardhur sëri një mesazh tjetër, "vetëm ri aty, nëse e shikon më njofto". Në momentin kur Jurgen Kurti ka dalë nga palestera, Leventi shkruan: "Doli një person, por nuk jam i sigurt nëse është Jurgen Kurti". "Është një djalë i gjatë, i beshëm", i përgjigjet mesazhshkruesi. Momentet kur Leventi shkëmben mesazhet janë fiksur nga kamerat. Fill më pas vritet Kurti. Edhe ekzekutimi i të riut është filmuar. Nga

këqyrja rezulton se prej "Benz"-it del një person dhe pasi merr diçka në dorë, bën veprime të njëjta me ato të qitjes me armë. "Benz"-i fillon lëvizjen drejt ish-lokal "Shushicës" e më vonë konstatohet tek Kopshti Zoologjik. Ndërkaq, Leventi del përpara postës dhe merr një taksë e nisat drejt qendrës së Liqenit. Aty ndalon për të blerë një paketë cigare. Rikthehet në makinë dhe më vonë shfaqet në afërsi të Liqenit të Thatë. Aty ngjitet në automjetin tip "Benz". Pranë "Benz"-it mbërrin dhe një automjet tip "Audi", në pronësi të Olsi Qalliaj, që shfaqet në kamera pranë vendit të ngjarjes. Pasi bëhen

bashkë të rinjtë, njëri prej tyre shkëputet me një qese dhe shkon drejt Liqenit të Thatë, ndërsa dy të tjerët ikin në drejtim të pallateve. Të tre dalin 25 minuta më vonë. Njëri iken me "Audi", tjetri shkon merr qesën, ndërsa i treti kthehet në shtëpi. Të nesërmen ata lëvizin "Benz"-in, ndalojnë fillimisht në një market në zonë e më pas fillojnë lëvizjen normale. Në ndihmë të policisë erdhën sërisht kamerat, që fiksan targën e makinës, e cila rezultoi në pronësi në Klodian Banes. Në këtë mënyrë u ra në gjurmë e personave të dyshuar, tre prej të cilëve gjykata caktoi masën e "Arrestit me burg".

SHPLLJE ANKANDI
 Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall.64, Hyrja B, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 25.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i llihtë për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale B518, me adresë Lajca 13, Plazhi, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Çirrim Sejfulla Xhafa dhe Znj. Bardha Xhema Xhafa me vlerë fillësore në ankand 20.454.84 (Njëzet mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë tëelëdhjetë e katër) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
 Rr. "Tish Dala", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kl. 1, Tiranë
 Web: www.3h.al, Email: shqgj.3h@yaho.com, cel:0692099711
 Njofton shpalljen e ankandit nga dt.26.03.2019 deri ne dt. 04.04.2019 per: sendin e luajtshem mjeti me targë DR 9619 D ne pronesi te Hysni Gjeqirj
Cmimi fillestar eshte 560 EURO
Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 04.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Shoqëria përmbarimore JUSTITIA
 Shoqëria përmbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e DYTE, për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vlerë fillësore: NISG BANK/AGI BANK, me kulla të dhjetë: Nr. 11887-NI, ZK. 8562, VOL. 30, FAQ. 91 e llojit njësi me sip. 109 m² ndodhur në adresën Rruga "Fuat Baban", Korçë ne pronesi te Pandelli Bonja.
 Cmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 48.832 EUR (dyzetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) EUR
 Nr. 1787-N3, ZK. 8562, VOL. 30, FAQ. 93 e llojit njësi me sip. 89.2 m² ndodhur në adresën Rruga "Fuat Baban", Korçë ne pronesi te Pandelli Bonja.
 Cmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 39.961 EUR (tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) EUR.
 Ankandi zhvillohet ne datën 29.04.19, ne perkandim te orarit zyrtar, ora 16:30 ne zyren e permbarimit gjyqësor, me Adrese: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studijostilla.com, tel. +355 4 2270890

LIBERALIZIMI I VIZAVE KOMENTET

Haradinaj: BE t'i japë epilog çështjes së vizave për Kosovën

Liberalizimi i vizave të Kosovës, voton pro Parlamenti European

Fajon: Kosova i ka përmbushur obligimet, KE-ja të veprojë tani

Parlamenti European ka votuar në favor të heqjes së regjimit të vizave për Kosovën ditën e djeshme. Këtë e ka bërë të ditur raportuesja për Kosovën në PE, Tanja Fajon, e cila ka thënë se e inkurajon Këshillin European që të veprojë tani. "Shumica kanë votuar në të mirë të liberalizimit të vizave për Kosovën. I bëjmë thirrje Këshillit European të veprojë tani". Ditën e mërkurë ajo tha nëpërmjet një postimi se Bashkimi Evropian ka dështuar që të realizojë premtimet e tij ndaj Kosovës. "Rritja e radikalizimit nuk ka të bëjë me kufizimin e udhëtimit, sidomos për të rinjtë. Rritja e radikalizimit mund të jetë rezultat i izolimit të Kosovës dhe dëshpërimit, pasi BE-ja ka dështuar të realizojë premtimin e saj", është shprehur ajo. Fajon e ka përmendur sërish se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet e vëna nga blloku evropian. Përveç kësaj, ajo ka thënë: "Nëse ju sot thoni se Kosova nuk i ka përmbushur obligimet, jeni duke gënjyer, jeni duke u treguar të papërgjegjshëm". Përveç kësaj, raportuesja për Kosovën ka thënë përmes një postimi në "Twitter" se, "Evropa është duke humbur kredibilitetin dhe qytetarët e Kosovës po humbin shpresën". Ky votim ka qenë pjesë e një hapi ligjor, në mënyrë që të vazhdohet mandati i këtij procesi edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet në Bashkimin European do të mbahen në muajin maj. Procesi i liberalizimit të vizave ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit European ka filluar në vitin 2012. Bashkimi European i kishte vënë Kosovës si detyrë të plotësojë 95 kritere për të marrë rekomandimin pozitiv për liberalizim të vizave nga Komisioni European. Një rekomandim të tillë, Komisioni European e ka bërë në korrik të vitit 2018, ndërsa në shtator të po atij viti, Parlamenti European kishte votuar në favor të liberalizimit të vizave për Kosovën, njofton "Klan Kosova". Në muajin dhjetor të



Eurodeputetja, Tanja Fajon

TANJA FAJON

"Shumica kanë votuar në të mirë të liberalizimit të vizave për Kosovën. I bëjmë thirrje Këshillit European të veprojë tani. Nëse ju thoni se Kosova nuk ka përmbushur obligimet, jthesht jeni duke gënjyer, jeni duke u treguar të papërgjegjshëm", ka thënë Fajon.



STOLTENBERG, EDHE DY VJET NË KRYE TË NATO-S

Ditën e djeshme NATO ka vendosur të zgjasë mandatin e sekretarit të përgjithshëm, Jens Stoltenberg edhe për dy vite të tjera. Aleatët e NATO-s dhe kanë rënë dakord të zgjerojnë mandatin e kreut të kësaj organizate deri më 30 shtator 2022, thuhet në deklaratë, ka shkruar i pari i NATO-s në "Twitter". Jens Stoltenberg, i cili ka qenë kryeministri norvegjez në dy mandate, nga 2000 në 2001 dhe nga viti 2005 deri në 2013, u emërua sekretar i përgjithshëm i NATO-s, më 1 tetor 2014.

Ditën e djeshme Parlamenti European ka votuar me një shumicë votash pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Ndërkaq, përmes një deklaratë, komisioneri për Migrim në Parlamentin European, Dimitris Avramopoulos, thotë se ndihet mirë që Parlamenti European e njëjshëm të lëvizet së lirë për qytetarët e Kosovës. Ai theksoi gjithashtu se ka një numër shtetesh anëtare të BE-së, të cilat kanë shprehur shqetësime rreth rrezeve të migrimit që paraqesin qytetarët e Kosovës. Komisioneri për Migrim në Parlamentin European, Dimitris Avramopoulos ka bërë të ditur

Komisioneri për Migrim në PE: Rajoni të ketë perspektivë europiane

Parlamenti European voton, Avramopoulos: Kosovarët e meritojnë liberalizimin



se dje është diskutuar për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Përmes një deklaratë, ai thotë se ndihet mirë që Parlamenti European e njëjshëm të lëvizet së lirë për qytetarët e Kosovës. "Më vjen mirë që Parlamenti European po e njëjshëm të lëvizet së lirë për qytetarët e Kosovës. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me të qenit të drejtë, por edhe me pranimin e përpjekjeve të tyre. Ka të bëjë me stabilitetin dhe sigurinë në gjithë rajonin. Igjithë

rajonin duhet të ketë perspektivë evropiane", shkruan në rrjetet sociale Avramopoulos. Siç shkruan komisioneri për Migrimin, kjo është arsyeja pse është propozuar heqja e aplikimit për viza për qytetarët e Kosovës, në kuptimin se deri në ditën e miratimit të propozimit nga Parlamenti dhe Këshilli, Kosova do të kishte ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Ma-

lin e Zi dhe duke forcur luftimin e saj kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit. Avramopoulos theksoi gjithashtu se ka një numër shtetesh anëtare të BE-së, të cilat kanë shprehur shqetësime rreth rrezeve të migrimit që paraqesin qytetarët e Kosovës. Kosova është i vetmi partner i Ballkanit Perëndimor, që nuk përfiton nga një marrëveshje e lehtësimi për viza dhe qytetarët e saj janë të vetmit në rajon që kanë nevojë për viza për të udhëtuar në vendet e Bashkimit European -ka përsëritur Komisioneri për Migrim, Dimitris Avramopoulos.

vitit të kaluar. Këshilli i Ministrave nuk e vendosi fare në agjendën e takimit çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. Kosova është vendi i vetëm në rajon, qytetarët e së cilës i nënshtrohen regjimit të vizave në zonën Shengen. Nga ana tjetër, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka thënë se në Parlamentin European me 331 vota pro është konfirmuar fillimi i dialogut për liberalizimin e vizave për Kosovën. Një vullnet kaq i fuqishëm politik, që buroi dje nga Parlamenti European në Strasburg, rikonfirmim për të disatën herë se institucionet e Kosovës i kanë përmbushur të gjitha kushtet e parashtruara, siç e ka konfirmuar edhe Komisioni European në Bruksel vitin e kaluar. Është tërësisht e padrejtë, frustruese dhe dekurajuese që qyteta-

rëve të Kosovës vazhdon t'u mohohet drejta e fituar për lëvizje të lirë në Europë. Në emër të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës, u bëjmë thirrje kryeqyteteve të shteteve anëtare të Bashkimit European që t'i japin drejtimit dhe epilog çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën, si e drejtë e fituar dhe e pakontestueshme, tani kur bëhen shtatë vjet nga data kur na është dorëzuar udhërrëfyesi për vizat. Kosova vazhdon të mbetet e fokusuar në përkushtimin e saj për avancimin e rrugës sonë drejt Bashkimit European dhe u qëndron fuqishëm besnike vlerave dhe parimeve, për të cilat jemi zotuar bashkë në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

re të Kosovës vazhdon t'u mohohet drejta e fituar për lëvizje të lirë në Europë. Në emër të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës, u bëjmë thirrje kryeqyteteve të shteteve anëtare të Bashkimit European që t'i japin drejtimit dhe epilog çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën, si e drejtë e fituar dhe e pakontestueshme, tani kur bëhen shtatë vjet nga data kur na është dorëzuar udhërrëfyesi për vizat. Kosova vazhdon të mbetet e fokusuar në përkushtimin e saj për avancimin e rrugës sonë drejt Bashkimit European dhe u qëndron fuqishëm besnike vlerave dhe parimeve, për të cilat jemi zotuar bashkë në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Kosova përshëndet votimin e PE-së

Veseli: Jemi i vetmi vend i izoluar i Europës

Krerët e institucioneve të Kosovës kanë përshëndetur qëndrimin e Parlamentit European, i cili ka votuar për të vazhduar mandatin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Votimi për vazhdimin e mandatit për liberalizimin e vizave për Kosovën, për krerët e shtetit të Kosovës konfirmim se institucionet i kanë përmbushur të gjitha kushtet e parashtruara nga Komisioni European. Edhe pse e kanë përshëndetur këtë votim, ata kanë qenë kritikë për zvarritjen e procesit. "Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret, të cilat janë dashur për të fituar të drejtën e lëvizjes së lirë të qytetarëve tanë. Jemi vendi i vetëm, jemi qytetarët e vetëm që për 11 vite si qytetarët më pro evropianë, më pro perëndimorë, jemi të izoluar", thotë kreu i Kuvendit, Kadri Veseli.



Behgjet Pacolli: Jepini fund një izolimi paradoksal

Ministri i Jashtëm: Institucionet e tjera të BE-së të respektojnë vendimin e Parlamentit

Ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli, ka kërkuar nga institucionet e Bashkimit Evropian që të ndjekin shembullin e Parlamentit Evropian, duke liberalizuar vizat për qytetarët e Kosovës. Përmes një shkrimi në "Facebook", Pacolli tha se lëvizja e lirë në Evropë është e drejtë themelore njerëzore. "Përkrahje e lartë e Parlamentit Evropian për çështjen e liberalizimit të vizave. Është koha që edhe institucionet tjera bashkëvendimmarrëse të Bashkimit Evropian të respektojnë verdiktin e këtij tempulli të demokracisë evropiane. Në fakt, përbushja e kritereve nga ana e



Ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli

Republikës së Kosovës ka qenë përkushtimi i ynë për t'u bërë pjesë e një komuniteti më të madh demokratik, familjes së vendve demokratike. Liberalizoni vizat, lëvizja e lirë në Evropë është e drejtë themelore njerëzore. Mos na

ndalni rritjen demokratike të vendit tonë të ri, jepni fund një izolimi paradoksal", ka shkruar Pacolli. Ndërkaq, Parlamenti Evropian ka votuar në favor të heqjes së regjimit të vizave për Kosovën. Ky votim ka qenë pjesë e një hapi ligjor, në

BEHGJET PACOLLI

"Në fakt, përbushja e kritereve nga ana e Republikës së Kosovës ka qenë përkushtimi i ynë për t'u bërë pjesë e një komuniteti më të madh demokratik, familjes së vendeve demokratike. Liberalizoni vizat, lëvizja e lirë në Evropë është e drejtë themelore njerëzore. Mos na ndalni rritjen demokratike të vendit tonë të ri, jepni fund një izolimi paradoksal", ka shkruar Pacolli.

mënyrë që të vazhdohe mandati i këtij procesi edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet në Bashkimin Evropian do të mbahen në muajin maj.

SHKURT

Limaj, pas votimit në PE: Qytetarët po mbahen padrejtësisht të izoluar

Zëvendësiministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka deklaruar se është lajm i mirë që Parlamenti Evropian ka konfirmuar edhe një herë që Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret e përcaktuara për liberalizimin e vizave. Përmes një shkrimi në rrjetin social "Facebook", Limaj ka shtuar se kjo megjithatë nuk është e mjaftueshme, pasi që tashmë Kosova duhet të lëvizë lirisht dhe pa viza. "Vullneti i treguar në Parlamentin Evropian duhet të kulmojë me heqjen e vizave në një të ardhme sa më të afërt. Qytetarët tanë po mbahen padrejtësisht të izoluar dhe kjo padrejtësi duhet të përfundojë sa më parë", ka shkruar ai. Ndërkaq, raportuesja për Kosovën në PE, Tanja Fajon ka thënë se e inkurajon Këshillin Evropian që të veprojë tani.



FATMIR LIMAJ

"Vullneti i demonstruar në Parlamentin Evropian duhet të kulmojë me heqjen e vizave në një të ardhme sa më të afërt. Qytetarët tanë po mbahen padrejtësisht të izoluar dhe kjo padrejtësi duhet të përfundojë sa më parë", ka shkruar Limaj.

Ministria Hoxha: Sërish u konfirmua puna jonë në Parlamentin Evropian

Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka reaguar pas votimit pozitiv në Parlamentin Evropian, për liberalizimin e vizave. Pas votimit pro me 331 vota të Raportit të Tanja Fajon për liberalizim, ministria Hoxha ka theksuar: "Ne e kemi merituar liberalizimin, kemi kërkuar trajtim të barabartë me shtetet e deritashme aspirante për liberalizim, përjashtimi ynë, është shumë i padrejtë". Postimi i ministres Hoxha në "Facebook": "Raporti i Tanja Fajon për liberalizimin e vizave i votuar me 331 vota është rikonfirmim i punës së institucioneve tona. Ne e kemi merituar liberalizimin, kemi kërkuar trajtim të barabartë me shtetet e deritashme aspirante për liberalizim, përjashtimi ynë, është shumë i padrejtë. Faleminderit Znj. Fajon dhe eurodeputetë që keni qenë përkrahës të së vërtetës!". Parlamenti Evropian dhe ka votuar sërish për të vazhduar mandatin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, të raportueses Tanja Fajon, si pjesë e procedurës për të vazhduar mandatin i këtij procesi edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet për Parlamentin Evropian do të mbahen në muajin maj.



Strasbourg: Rekomandohet fillimi i negociatave Maqedoni-BE në muajin qershor



ishit në sferat e konfirmuara me konkludimet e këshillit dhe t'i hapë rekomandimet për hyrje në BE në qershor të këtij viti. Krerët e komitetit janë të bindur se hapja e negociatave në qershor të vitit 2019 do të sigurojë nxitje të mëtejshme për konsolidimin e demokracisë dhe qeverisjes së të drejtës, si dhe përforcim të mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë". Në rekomandimet është përsëritur avancimin e arritur i Maqedonisë së Veriut dhe njëkohësisht është inkurajuar për të vazhduar me përpjekjet e saj për konsolidim të mëtejshëm të reformave, të cilat janë nga rëndësia esenciale për vendin, veçanërisht në sferën e gjyqësisë, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, shërbimet e zbulimit dhe të sigurimit, si dhe reformat në administratën publike. Përgëzohet për përcaktimin e partive qeveritare dhe opozitare në mbështetje të synimit të përbashkët strategjik për hyrje në BE dhe bëjnë thirrje në bashkim kombëtar në këtë pikëpamje; u bëjnë thirrje autoriteteve në Maqedoninë e Veriut, të gjitha partitë politike dhe

shoqëritë civile t'i ndajnë përpjekjet e tyre në muajt në vijim që të mund të dëshmojnë se janë partnerë të parashikueshëm dhe të sigurt. Komiteti i Përzier Parlamentar gjithashtu përgëzoi avancimin e vazhdueshëm në hetimet e zbatuara nga ana e Prokurorisë Speciale Publike për vendosjen e përgjegjësisë juridike për përgjimin e thekson rëndësinë e hetime të pavarura nga ana e Prokurorisë Speciale Publike dhe gjykatat, për mundësinë për t'i zbatuar hetimet e tyre për të gjitha rastet e pazgjidhura dhe t'i nxjerrin përgjegjësit para drejtësisë dhe vëren rëndësinë për zgjidhje të qëndrueshme për statusin e ardhshëm të Prokurorisë Speciale Publike dhe gjyqësisë. Ata marrin parasysh harmonizim gradual të kornizës ligjore të Maqedonisë së Veriut me standardet e BE-së. Përveç kësaj, gjithashtu kërret vërejtje që janë bërë hapa që nga qeveria për përmirësimin e mjedisit operativ për institucionet e pavarura mbikëqyrëse, medimet dhe organizatat joqeveritare, si dhe dialogun e përmirësuar midis qeverisë dhe organizatave joqeveritare. Por vërejtje edhe shqetësimin lidhur me mungesën e ndryshimeve të dukshme në lirinë e medimeve, presionin ndaj gazetarëve dhe vetë censurën. Krerët ndjejnë keqardhje që edhe krahas përmirësimit të keq në krahasim me vitin paraprak, vendi mbetet në kategorinë e shteteve "pjesërisht të lira" në indeksin e fundit "Liri në botë". Komiteti i Përzier Parlamentar ankohe

për vendimin e opozitës për ta ndaluar pjesëmarrjen e saj në procesin Zhan Mone dhe bën thirrje në përforcim të kulturës në kompromis dhe dialog konstruktiv politik veçanërisht midis deputetëve dhe në përmajtje nga krijimi i çfarëdo pengese që s'do lejojë funksionimin efektiv të parlamentit, e theksojnë rëndësinë që të sigurohet se parlamenti mund në tërësi t'i shfrytëzojë funksionet e veta mbikëqyrëse dhe ligjvënëse. Edhe nëqerë ata theksojnë se vendosja e përgjegjësisë për ata që i kanë kryer dhe i kanë orkestruar këto akte të dhunës nga 27 prilli i vitit 2017 në parlament duhet të vazhdojë të vendosen në harmonizim me ligjin, në mënyrë transparente dhe të pavarur. KPP-ja e thekson rëndësinë nga mbajtja e regjistrimit, që të merret statistikë e përshtatshme dhe reale demografike në pajtim me standardet evropiane dhe e thekson rëndësinë në konsensus të gjerë politik në këtë pikëpamje. Me këtë rast përgëzojnë qëllimin e qeverisjes për të kryer pilot-regjistrim në vitin 2019 dhe regjistrim në vitin 2020. Në fund theksojnë nevojën që të sigurohet se zgjedhjet presidenciale do të mbahen në atmosferë të pajtimit kombëtar dhe në mënyrë korrekte dhe transparente. Krerët e Komitetit të Përzier Parlamentar theksojnë nevojën për rishikim në kohë të Kodit zgjedhor me zgjidhje gjithëpërfshirëse të rekomandimeve të mbetura të OSBE/ODIHR-së, Komisionit të Venecias dhe GREKO, duke përfshirë edhe për financimin e fushatave dhe për partitë politike.

Rrëfëhet aktori: Vdekja do më ndante nga teatri, betejën e fituan qytetarët

Neritan Liçaj:

Politikën në Shqipëri do ta krahasoja me ujin e Lanës

"Çdo gjë e kam fituar vetë, jeta ime u takon djemve"

Egla Xhemali

Teatri është tempulli i aktorëve. Lufta ndaj prishjes së tij, zëri që kumbonte më fort e që vazhdon të jetë i palëkundur edhe pse ka kaluar një vit e dy muaj nga çështja e shumëpërfolur për prishjen e Teatrit Kombëtarë vjen në një rrëfim për "Gazeta shqiptare" për të hedhur dritë mbi kauzën e madhe si dhe për të na zbuluar disa detaje të tjera përtej botës së aktrimit. Neritan Liçaj është një nga aktorët më të dashur për publikun shqiptarë, me një numër të madh rolesh në filma dhe teatër, një figurë e çmuar që ka bërë çmos për mosprekjen e teatrit, vlerës së jashtëzakonshme kulturore që mbart ai ndër vite. Liçaj na tregon për të veçantën e roleve të tij në skenë, ku ndër ta do zgjidhte të luante përsëri "Hamletin" duke e aktualizuar situatën me Shqipërinë. Aktori ndan me ne momentet e improvizimeve, kur papritur ka haruar pjesën e megjithatë ia ka dalë me sukses. Të gjithë dashamirësit e teatrit dhe aktorit natyrisht, do kenë mundësinë ta shohin me dy projekte në skenë. Pasioni i mposht të gjithë madje edhe situatat më të vështira, kur bëhet fjalë për luhatjet shëndetësore. Përtej aktrimit, Neritani thotë se jeta e tij u takon dy djemve e se nga rrugëtimi jetësor nuk ka asnjë peng deri më tani. Më tej, aktori bën një krahasim të politikës në Shqipëri me ujin e Lanës.

U bën kaq vite në skenë. Momenti që do e veçonit si më bukurin?

Janë pafund, gjithsesi ai më pikanti është kur publiku të duartroket me zemër. Dallohet kur duartrokasin për kortezi dhe kur i ke rrokur, përfshirë tronditur. Gjithçka u lexohet në sy. Ai është momenti i magjishëm dhe i pakrahasueshëm që të jep jetë.

Një rol që do e luanit pafund dhe pse?

Janë shumë role, por do veçoja Hamletin sepse është



tipik për këtë vend, për Shqipërinë. Kur ti ndihesh i vrarë dhe i tradhtuar çdo moment të jetës tënde. Shqipëria dhe arti në vend është i mbushur me Klaud.

Situata më e sikletshme në skenë?

Nuk kam pasur dhe kur jam futur me 40 temperaturë ose me dhimbje dhëmballe, që të shkulte skalpin ose me penj ende në barkë nga operacioni. Aty të zhiduken të gjitha, në atë tempull që sot e kanë përlyer dhe

që quhet skenë.

Çasti kur keni haruar pjesën. Si keni reaguar?


Kam pasur natyrisht. S'ka aktor besoj, në historinë e njerëzimit të mos e ketë kaluar, gjë që ndodh në teatër, madje ky i fundit është i bukur dhe për këto momente. Kam improvizuar dhe kam dalë nga situata. Projekte të reja? Nën petkun e kujt personazhi do ju shohim? Ende nuk e di, pasi tani situata e teatrit është e anulit dhe nuk dihet qartë se

çdo ndodhi. Kam dy projekte, por të shohim si do vendosin drejtorët e rilindjes, regjisorët lëpirës deputetësh dhe drejtoreshë rilindja. (qesh) Dihet që i ndajnë rolet regjisorët e rilindjes.

Nga beteja për teatrin, kush doli fitues?

Teatri dhe ata që e duan vërtetë dhe luftuan për të. Mbi të gjitha fituan qytetarët, që e duan teatrin dhe që ishin të shumtë në mbështetje ndaj kauzës së madhe.

Si baba, nga çfarë keni



hequr dorë?

Nga jeta ime. Si baba, jeta ime u takon atyre të dyve. Gjithçka është e tyre, e djemve të mi.

Arsyeja që do ju largonte përfundimisht nga aktrimi?

Vdekja, asgjë tjetër.

Pengu më i madh që keni nga rrjedha e kohës?

Ikja e viteve, por nuk i jam pishman jetës së deri tanishme. E kam jetuar fort bukur, jo rrallë herë lodhshëm, kam rënë, jam ngritur,

kam gabuar dhe kam mësuar nga ato. Kam gëzuar dhe jam lumturuar me jetën time. Çdo gjë e kam fituar vetë dhe kam jetuar me zemër. Nuk i kam asnjë pishman rrugëtimi jetësor nëpër të cilin kam kaluar deri më tani.

Me çfarë do e krahasoni politikën në Shqipëri?

Me ujin e Lanës. Kryeministrin aktual që është personifikimi i ujit të Lanës me gjithë matrioshkatë të tij të "rilindjes" së vdekur që në embrion.



Luana u kërkon falje fansave, zbulon çfarë është duke ndodhur

Ajo është një nga personazhet më të dashur për publikun shqiptar. E kemi fjalën për Luana Vjollcën. Këto ditë moderatorja seksi ka preferuar të rrijë larg rrjeteve sociale, që pas publikimit të fotos nga një studio muzikore dhe nga po e njëjta studio ka postuar edhe Krenari në 'Instagram-in' e tij, duke lënë të kuptohet se qëndron pranë saj në çdo moment. E duke qenë se Luana nuk ka qenë aktive në 'Instagram', siç duket fansat e saj e kanë ndjerë mungesën dhe moderatorja e ka parë të arsyeshme t'u kërkojë falje atyre. "Më falni që nuk ju kam kushtuar shumë kohë, por po punoj fort për të sjellë gjëra të bukura te ju", ka shkruar Luana.



Modele e Victoria's secret? Oriola: Kam lindur për një arsye të madhe

Oriola Marashi është një nga modelet më seksi dhe më të komentuar të momentit. Së fundmi, bukuroshja ka publikuar disa foto që janë realizuar në Romë. "Ok, më adhuroni", ka shkruar Oriola në imazhin, ku shfaqet me një fustan të çarë anash, që i nxjerr në pah linjat e saj perfekte. Një prej tyre shkruan me ironi "Po pres komentin e atyre dështakeve që do të thonë që je për te Victoria Secret". Modelja i tha: Po nuk është ai qëllimi im, për të bërë atë duhet të jetosh në Amerikë, unë nuk rri dot larg prindërve dhe shoqërisë kështu që nuk besoj se do largohesha dot nga vendi im, do bëj gjëra të mira në jetë... "Fansja vijoi të shkruante se modelet e Victoria's janë 23 vjeç dhe Oriola është 25 me idenë që i ka ikur moshja, por Oriola i tha që është 23 dhe i dha disa informacione për moshën e modeleve seksi të Victoria's Secret. Më pas ajo e mbylli bisedën me një fjali shumë të bukur: "Unë besoj shumë në zot dhe unë e di që kam lindur për një arsye më të madhe se kaq."



Kush duket më bukur? Kejvina kopjon Lori Hoxhën

Në botën e show bizz-it nuk mungojnë rastet kur Vip-at shpesh me dashje ose pa dashje gjenden në publik me veshje të njëjta dhe kjo ndodh për arsye nga më të ndryshmet. Personazhet e radhës që kanë bërë xing janë pikërisht Lori Hoxha dhe Kejvina Kthella e bëhet fjalë për kostumin ngjyrë rozë, me të cilin kanë bërë dalje publike. Në fakt, ishte Lori ajo që e veshi e para, kur dy ditë më parë postoi një foto e veshur me kostumin, pantallona e xhakëtë prerje paksa për djem, por që duket shumë bukur. Ndërsa ditën e djeshme Kejvina u shfaq e veshur me të njëjtin kostum në premierën e "2 gisht mjaltë", por me një ndryshim të vogël pasi jaka vjen pak më e ngritur, ndryshe nga Lori që ka preferuar versionin e jakës së thellë.



Sherri mes Beatrixit dhe Anxhelinës, mësoni përse nuk flasin kushërirat

Ato u vunë në qendër të mediave rozë si pasojë e një sherri. Dy këngëtares e njohura Anxhelina dhe Beatrix Ramosaj nuk e ndjekin më një-tjetrën në 'Instagram'. U përfol se arsyeja e sherrit mes kushërirave ishte make-up artisti Ariel, i cili është mik i ngushtë me Anxhelinën. Megjithatë lidhur me këto lajme askush nga pjesëtarët e familjes nuk foli. Por, siç është vënë re kohët e fundit marrëdhëniet e tyre janë përmirësuar. Kështu tezja e tyre i ndjek sërish nipërit në 'Instagram' dhe pak ditë më parë, Albëria e uroi Albanin për ditëlindje. Po ashtu, Beatrixin ndodhet në pushime me Agnesën, motrën e Anxhelinës dhe vajzën e saj Elekta. Beatrixin i ka rregulluar marrëdhëniet me të gjithë përveç se me Anxhelinën, e cila vazhdon të mos ndjek në 'Instagram' as Beatrixin dhe as Albanin.



PAGAT E MËSUESVE VENDIMI

Kriteret dhe shpërblimet për nëpunësit, nga titullar institucioni te specialistët

Vendimi i qeverisë, kategoritë e pagave për mësuesit e arsimit parauniversitar

Shtesat e kualifikimit sipas pozicionit të punës

Voltiza Duro

Nëpërmjet miratimit të një vendimi, Këshilli i Ministrave ka bërë disa ndryshime dhe shtesa për sa i përket pagave të mësuesve të arsimit parauniversitar ditën e djeshme. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot tabelën e plotë me kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në Drejtorinë

FONDET
Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i vendimit për vitin 2019, do të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe do të fillojnë nga momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve në pozicionet e reja, pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse.

Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe shtesat përkatëse të kualifikimit. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.

10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pa-

gat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave vendosi: Pika 12/1 ndryshohet", -thuhet në vendimin e qeverisë. Sipas këtij të fundit, kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në drejtoritë rajonale të arsimit



Foto ilustruese

parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar janë sipas lidhjes nr. 9/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2019, do të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe do të fillojnë nga momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve në pozicionet e reja, pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse. Ky vendim hyri në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

"Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon: a) Në fund të pikës 1/3/a shtohet emërtesa "Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar"; b) Në shkronjën "b", të pikës 1/3: i) emërtesat "Instituti i Zhvillimit të Arsimit" dhe "Inspektorati Shtetëror i Arsimit" shfuqizohen; II) shtohet emërtesa "Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar", -thuhet më tej në vendim.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe shtesa e kualifikimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA E KUALIFIKIMIT
Drejtor i drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar	III-b	1	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%
Drejtor i zyrave vendore të arsimit parauniversitar, përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	IV-a	1	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%
Përgjegjës sektori në zyrat vendore të arsimit parauniversitar	IV-b	1	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%
Specialist në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	IV-b	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%
Specialist në zyrat vendore të arsimit parauniversitar	IV-c	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe shtesa e kualifikimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA E KUALIFIKIMIT
Titullar i institucionit	II-a	1	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	1	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
Specialist në sektorët e përmbajtjes	IV-a	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë ("Mësues i kualifikuar") - 30% Shkalla e dytë ("Mësues specialist") - 40% Shkalla e parë ("Mësues mjeshtër") - 50%
Specialist në sektorët mbështetës	IV-a	1 ose 2 ose 3	0
	IV-b		

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

NJOFTIM PËR MEDIA

Policia e Kosovës (PK) me qëllim, të informimit të mediave dhe opinionit publik, ju adreson këtë njoftim zyrtar i cili ka të bëjë me një shkresë të pranuar përmes kanaleve zyrtare nga Zelanda e Re. Shkresa zyrtare e pranuar nga Departamenti i Punëve të Brendshme i Zelandës së Re, i referohet tragjedisë së ndodhur në Christchurch, i cila u vlerësua si sulm ter-



rorist, dhe me këtë rast Zelanda e Re është duke bashkëpunuar me partnerë vendor dhe ndërkombëtar, përf-

Informacion i pranuar nga Zelanda e Re, Prishtinë, 28 mars 2019

shirë edhe Policinë e Kosovës, që t'i largojë pamjet online në lidhje me sulmin. Të njëjtit kanë konsideruar se pamjet e këtij sulmi janë të kundërligjshme dhe të pa këndshme sipas ligjit të Zelandës së Re, prandaj përmes partneritetit dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë kërkojnë edhe ndi-

hmën tonë në largimin e kësaj pamje online të këtij sulmi dhe shpërndarjen e mesazhit të tyre. Policia e Kosovës si institucion i zbatimit të ligjit, me qëllim të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër akteve terroriste, ju adreson këtë informacion të pranuar nga Zelanda e Re për

largimin e pamjeve online të sulmit dhe njëkohësisht largimin e pamjeve me përmbajtje të kësaj natyre. Pamjet mund t'i raportoni drejtpërdrejt në platformën ku hasen pamjet, gjithashtu, për çfarëdo lloj informacioni, ankese apo problemi lidhur me këtë mund ta adresoni në Policinë e Kosovës në emailin zyrtar info@kosovopolice.com apo edhe direkt përmes faqes së censuruar të internetit.

Masakra në dy xhamitë, sulmi që u frymëzua nga luftërat në ish-Jugosllavi

Zelanda e Re kërkesë Kosovës: Hiqni pamjet e sulmit terrorist

Policia kosovare: Pranojmë të largojmë videon online

Menjëherë pas sulmit terrorist që ndodhi vetëm dy javë më parë në Christchurch të Zelandës së Re, ku vrasja e 50 besimtarëve myslimanë u filmua dhe u publikua në rrjetet sociale, shumë shtete ndërmorën masa për dënimin e të gjithë atyre që shpërndajnë pamjet e këtij sulmi terrorist. Kërkesa për ndalimin e shpërndarjes së pamjeve të sulmeve terroriste është bërë edhe për territorin e Kosovës. Pak caste më parë Policia e Kosovës ka njoftuar se nga autoritetet përgjegjëse të Zelandës së Re kanë pranuar një kërkesë për ofrimin e ndihmës në ndalimin e shpërndarjes së këtyre pamjeve. Në një komunikatë për media të Policisë së Kosovës thuhet se "Zelanda e Re është duke bashkëpunuar me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe Policinë e Kosovës, që t'i largojë pamjet online në lidhje me sulmin". Ndër të tjera në këtë shkresë, pamjet e sulmit janë cilësuar "të kundërligjshme dhe të pakëndshme sipas ligjit të Zelandës së Re". Më 15 mars një 28-vjeçar nga Australia, ka kryer sulme në dy xhami në Zelandën e Re, duke lënë të vdekur 50 persona. Sulmuesi i xhamive e ka transmetuar drejtpërdrejt në rrjetin social, 'Facebook' aktin e tij. Kujtojmë se para sulmit të para dy javëve, përmes një videoje 17-minutëshe, të një prej sulmeve që kanë ndodhur më 15 mars në Kristçerç të Zelandës së Re, nis me një skenë ku një burrë e identifikon veten si Brenton Tarrant, teksa nisat drejt xhamisë, Al Noor, vend në të cilin janë vrarë 41 persona. Në prapavijë, dëgohet një këngë nacionaliste serbe dhe një zë robotik që drejton Tarrant në rrugën për ku është nisur. Kënga është thënë të jetë krijuar më



Pamje nga ngjarja e sulmit në Zelandën e re

1995, gjatë luftërave që kanë rezultuar me shpërbërje të Jugosllavisë në vitet 1990, dhe me vdekjen e rreth 130,000 personave. Kënga, që në fillim është quajtur "Karaxhiç, udhëheq serbët e tu", i referohet liderit të serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiç, i ashtuquajtur edhe si Kasap i Ballkanit, që është dënuar nga Tribunali Ndërkombëtar më 2016, për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ndërkaq vrasësi në Zelandën e Re, Tarrant, që përshkruan veten në këtë manifest si "burrë të thjeshtë, të bardhë dhe 28 vjeçar", me shtetësi australiane, e ka karakterizuar sulmin me elemente "anti-migrante, dhe kundër zëvendësimit të elementeve kulturore apo etnike". Tarrant pritet të paraqitet para gjykatës në Kristçerç më 16 mars. E përditshmja, The New Zealand Herald e ka përshkruar sulmin në xhami si vrasjen më masive në këtë shtet nga viti 1943.

AUTORI I SULMIT

Sulmuesi i xhamive e ka transmetuar drejtpërdrejt në rrjetin social, 'Facebook' aktin e tij. Kujtojmë se para sulmit të para dy javëve, përmes një videoje 17-minutëshe, të një prej sulmeve që kanë ndodhur më 15 mars në Kristçerç të Zelandës së Re, nis me një skenë ku një burrë e identifikon veten si Brenton Tarrant, teksa nisat drejt xhamisë,

BANGLADESH/ ZJARR NË NDËRTESE, NJERËZIT HIDHEN NGA DRITARET

Një zjarr masiv që përfshiu një ndërtesë i mori jetën të paktën 19 personave dhe mbi 70 të tjerë janë plagosur në Bangladesh, shkruan BBC. Zjarri ra në ndërtesën 19-katëshe në afërsi të një zone tregtare të kryeqytetit të Bangladeshit, Daka. Disa prej banorëve janë duke zbritur me litar, por edhe të tjerë që hidhen nga dritaret për të shpëtuar nga flakët. Numri i viktimave mund të rritet, pasi gjendja e disa prej personave të dërguar në spital është në gjendje të rëndë. Mediat lokale raportojnë se njerëzit që ishin brenda në ndërtesë bërtisnin dhe kërkonin ndihmë për të shpëtuar, ndërsa 6 janë parë duke u hedhur nga dritaret.



FOTOLAJM

SHKURT

17-vjeçari palestinez qëllohet nga trupat izraelite

Rreth 150 studentë palestinezë hodhën bomba zjarri dhe shkëmbinj mbi ushtarët izraelitë të cilët reaguan me gaz lotsjellës dhe plumb gome në Bregun Perëndimor të pushtuar të mërkurën pas një sulmi izraelit në universitetin e tyre, raporton Reuters. Gjithashtu, të mërkurën, një 17-vjeçar palestinez u qëllua për vdekje nga trupat izraelite gjatë përleshjeve me gurë në kampin e refugjatëve të Dheisha pranë qytetit të Bethlehem të Bankës Perëndimore, tha një zyrtar i shërbimit të ambulancës. Ai e identifikoi viktimën si vullnetarë që mbanin uniforme ndihmëse. Ushtria izraelite nuk kishte asnjë koment për vrasjen.

Mozambik, pesë persona preken nga kolera

Dhjetëra pacientë janë nisur drejt klinikave në qytetin Beira në Mozambik, pasi Qeveria ka thënë të ketë konfirmuar se pesë persona janë prekur nga kolera, pas ciklonit Idai që ka përfshirë këtë vend. Mijëra persona janë bllokuar në fshatrat e tyre për më shumë se një javë pa qasje në ujë të pijshëm, meqë cikloni ka shkakuar vërshime të rënda. Pjesëtarët e ekipeve të shpëtimit janë fokusuar në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse. Në qendër të qytetit Beira, doktorët dhe stafi tjetër spitalor janë duke trajtuar rreth 140 pacientë, disa prej të cilëve mezi kanë ecur. Autoritetet kanë shprehur shqetësimet e tyre për përhapje të virusëve të shumta, pas ciklonit që ka përfshirë edhe Zimbabven dhe Malavinë. Ky ciklon ka lënë të vdekur 700 persona dhe ka detyruar qindra mijëra të tjerë të largohen nga shtëpitë e tyre.

Kamioni merr përpara turmën, 32 viktima në Guatemala

Një kamion u fut në një turmë njerëzish në perëndim të Guatemalës mbrëmjen e së mërkurës, duke vrarë të paktën 32 persona. Kamioni goditi një grup njerëzish të cilët u kishin shkuar në ndihmë një personi tjetër, i cili ishte goditur nga një makinë. Lajmi u konfirmua nga një zëdhënës i departamentit lokal të zjarritikësës për Reuters. Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Carlos Soto, në një prononcim për mediat lokale konfirmoi se numri i viktimave është 32. Ai tha se të paktën 9 persona të tjerë ndodhen në spital, në gjendje kritike për jetën. Ngjarja e rëndë ndodhi në bashkinë e Nahuala, në perëndim të Guatemalës City Ky është një prej aksidentëve më të rëndë në vend përgjatë viteve të fundit. Në 2013-n, një autobus ra nga maja e një shkëmbi në një zonë rurale të Guatemalës, duke vrarë 43 persona e duke plagosur me dhjetëra të tjerë.

"Kujdes, vetëm nëse kaloni këtë testim mund të konkurroni për më tej"

Votliza Duro

Përgjatë muajt prill, infermieret e rinj do t'i nënshtrohen provimit të aftësisë praktik VAP "Gazeta Shqiptare" zbardh sot emrat e 1230 infermierëve që do të testohen si dhe datat përkatëse për secilin. UISH njofton se ky testim do të kryhet për të vlerësuar aftësitë që këta kandidatë kanë fituar gjatë praktikës në profesionet infermieri, mami, fizioterapi, teknik laboratorit, teknik imazherie dhe logopedist. "Ju bëjmë me dije se në ditën e provimit duhet të keni me vete kartën e identitetit, një përparëse të bardhë dhe kartën e praktikantit. Provimin do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike Tiranë, në QSUT", thuhet në njoftimin e Urdhrit të Infermierit. Gjatë vitit 2012, Urdhri i In-

Provimin, lista e plotë me 1230 kandidatët në Infermierin

Urdhri i Infermierit, testimi i aftësisë profesionale

fermierit ndryshoi kushtet për të gjithë kandidatët që dëshironin të hynin në provimin e shtetit. Sipas këtyre ndryshimeve, të interesuarit, përveç praktikës profesionale, i nënshtrohen një testimi profesional në fund të saj, ndërkohë që vetëm

nëse vlerëson pozitivisht në të, kanë të drejtë të regjistrohen për provimin e shtetit. Konkretisht, studentin i diplomuar në programet e studimit të sipërpërmendura, ditën që regjistrohet, merr librezën e praktikës profesionale.

Në këtë librezë mbahen shënimet ditore përgjatë 12 javëve që studentin realizon praktikën, të cilat firmosen çdo ditë nga drejtuesi i saj. Në fund, librezë e firmosur nga drejtuesit vlerësohet me një numër pikësh të caktuara. Saktësisht, ato

janë nga 10 deri në 25 pikë, të cilat i njihen kandidatit gjatë realizimit të testimit profesional. Ai e merr librezën, dhe 10 ditë para datës së provimit e dorëzon atë pranë Urdhrit profesional dhe regjistrohet për dhënien e testimit profesional.

KANDIDATËT NË INFERMIERI

INFERMIERI VAP DATA 01.04.2019 ORA 08.30

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 08:30 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 08:30 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 08:30 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 08:30 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 08:30 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 08:30 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 08:30 exam slot.

INFERMIERI VAP DATA 01.04.2019 ORA 18.00

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 18:00 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 18:00 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 18:00 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 18:00 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 18:00 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 18:00 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 18:00 exam slot.

INFERMIERI VAP DATA 02.04.2019 ORA 13.00

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kod. Lists candidates for the 13:00 exam slot.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

Table with columns: Nr, Emri Mbiemri Kodi, and data rows for individuals.

KRITIKA

Dhe ku është ky ekuilibri që njerëzit krijojnë mes tyre për të ndarë një vetëvrasje të pranueshme nga ajo e papranueshmja? Në shumicën e rasteve rrethanat janë të atilla, që opinioni yt është i papërdorshëm qoftë edhe për vetë ty.

Olton Kadaifciu*

"Natën, ma". Një pjesë për të qarë me dy personazhe. Ora e fundit para vetëvrasjes së një vajze që nuk po ia del dot më të mbajë barren e jetës. Plot kohë më herët fort i nderuari psikiatër që kisha nderin t'i numërohesha si kolegj lexonte në frëngjisht një libër për vetëvrasjen e më tregonte për rrëfimet që i tërhiqnin vëmendje. Profesor filani dhe e shoqja vendosin 30 vjet më herët që në filan moshë filan ditë të dy së bashku do ta mbyllin jetën, pse e gjykojnë që jeta varfërohet e mbas tridhjetë vjetësh bëjnë ashtu. Nga ai e lloj-lloj burimesh të tjera dimë: mendimet e Hjumit që thoshte se asnjë jetë që ia vente të ruhej nuk është humbur nga vetëvrasja; veprën e Gëtes "Vuajtjet e djaloshit Verter", që ai e mbyll me vetëvrasjen e heroit e që e ndoqën një sërë vetëvrasjesh, vdekja e Luçio Batis-tit nxit rritjen e vullnetit vetëvrasës ndër italianë, më tregonte dikur një kolege italiane, që kish shërbyer në një shërbim telefonik për njerëz me nevoja psikologjike të veçanta. Kadare na tregonte për ata kaukazinët andej që vrisnin veten për rritje të vëmendjes për veprën e tyre letrare. Ne vetë nderojmë vetëvrasjen heroike të vajzave që hidheshin e vetëvriteshin me ndonjë mënyrë, kur mbrojtja thyhej e hasmi i bëhej vendit zot deri tek ai shkëmb i thepsur në mal. Ajo që dua të them është se vetëvrasja ka një lirshmëri, që nuk është e papranuar ndër shokë e shoqe. Ka legjitimitet personal në të. Por nga ana tjetër është mëkat dhe Dante i digjte në lumin e zjarrtë Legeon, së bashku me dhunues të fqinjit apo të Zotit. E këto kahje janë ndër rivalitetet. Dhe ku është ky ekuilibri që njerëzit krijojnë mes tyre për të ndarë një vetëvrasje të pranueshme nga ajo e papranueshmja? Në shumicën e rasteve rrethanat janë të atilla që opinioni yt është i papërdorshëm, qoftë edhe për vetë ty.

Vepra e Marsha Norman, "Natën, ma", që është edhe fituese e një cmimi "Pulitzer" ka një vazjë në prag të vetëvrasjes. Jeton me të ëmën që pas divorcit dhe u bindet angazhimeve që kjo marrëdhënie ofron. E lindur me një sëmundje të trashëgueshme që ka edhe krizat epileptike ndër simptomat të veta, ka një mosvazhdimësi të kujtimeve në kohë. Por edhe një martesë. Një burrë që dikur iku, një djalë që u rrit jashtë vëmendjes së nevojshme dhe u dha në drogëra dhe kriminalitetin e nevojshëm për ta siguruar. Një rënie nga kali dhe pastaj trajtim me mjekime të reja, që sigurojnë një ruajtje më të shëndetshme të kujtesës.

E në fjalë të saj, pasi u kthjellua mbi ç'po ndodhte, vendosi të vrasë veten. Njofton e i lë porositë mamasë në orën e fundit. Një grua që është plakur dhe tashmë robinjë e një asketizmi sistematik. Me një shoqe që ka dy zogj. Me një djalë.

Me një burrë që gjithashtu kish vuajtur prej sëmundjes e kish krijuar me vajzën marrëdhënien e afërimitit familjar edhe në kurriz të marrëdhënies me gruan. Ai shkonte për peshk dhe nuk dilte nga makina, por rrinte brenda, e thurte me tel figurina.

E në këtë orë të fundit, një marrëdhënie familjare nënë e bijë. Vajza që është edhe duruese, edhe në hall. Ka marrë masa që e ëma të ketë kohë të mendojë duke ia bërë shtëpinë gati. I kërkon mirëkuptimin, bekimin e saj. E nëpër uljengritje emocionale, zbulojnë të panjohura që i mundonin prej kohësh. Diskutojnë. Zihen, qeshin, qajnë. Në fakt, qamë të tërë bashkë. Mezi i mbajtëm lotët. Regjisoria Ema Andrea vetë ishte dendur në të qarë. Unë nuk di as vetë nga e fsheha një lot që më rrodhi. Kur në fakt nuk u dëgjua as krisma e vetëvrasjes! Për ata si puna ime që ishin për ta parë pjesën për herë të dytë, pas asaj të para ndonja dy muajve, kur shfaqja ishte sërish te Metropoli, mungesa e krismës ishte me interes. Unë i mbreha veshët dhe ishte qetësi kur errë sira po binte dhe krisma po vononte. Nuk duket të ishte faji i armës, sepse as gishti në këmbëz nuk

Shfaqja e Ilire Vincës me Egla Cenon, nënë e bijë përballë



lëvizti.

Ata e dinin. Atë krismë e kishte pasur edhe Marsha Norman edhe regjisoria Ema Andrea në serinë e parë të këtyre vënieve në skenë. Çjanë këta lot?

Shfaqja tani.

Ema Andrea ka një pëlqim për teatrin anglofon të ca autorëve që eksplorojnë kufijtë e njerëzores në shoqërinë urbane. Të alienuar, disi të sëmurë, por njerëzorë. Sa më

njerëzorë. Ky eksplorim i vazhduar i zonjës Andrea në këtë brez të gjerë autorësh të spikatur që numëron Sarah Kane dhe Jon Fossen dhe ndonjë tjetër që unë nuk po di ta përmend tani, është tregues i një marrëdhënie me rëndësi të shtuar, i një besimi të shtuar në detyrat shoqërore të teatrit.

Ilire Vinca dhe Egla Ceno janë një zgjedhje fort e mirë e zonjës Andrea. Zonja Vinca e ka edhe

qetësinë e duhur edhe energjinë e bollshme në shpërthim. Ajo i di kufijtë e më shumt në emocion dhe ka forcë të mbajë tensionin e lartë të shtrirë të shtrirë rehat nëpër gjendje humorit e skena të gjata a të shpejta qofshin. Një aktore e arsyeshme, që nuk ka frikë të lëshohet më rrjedha emocionale të personazhit e t'ia ofrojë edhe shtatin, edhe portretin e vet...

Ceno është gjithashtu një emër i spikatur i skenës sonë. Dhe është përhapet brenda personazhit duke mbajtur vetë sa duhet. Edhe është e mobilizuar, e fortë dhe e praktikuar. Me një përdorim shumë të mirë të fjalës. Me lëvizje simbolike që përcjell emocione, me kumbime muzikale. Që në fillim skena është e ngritur arsyeshëm. Në një televizion me zë goxha të ulët, është një lexim aktiv i veprës, në anglisht me duket? Nja tre komodina si dollapë përreth. Ca rrëmujë, po jo aq shumë, por ca si më shumë. Tamam siç ka shkruar edhe autorja, por edhe me vibrime më të afërta. Megjithatë, publiku kishte kontribute të mira në suksesin e shfaqjes edhe si prani, edhe si aftësi për të akomoduar të vërtetat dhe vërtetësinë e veprës.

*Kritik

"URIMET MË TË MIRA PËR 1999" NË GKA

"Urimet më të mira për 1999" është printuar në një kartolinë përshëndetëse të konceptuar nga artisti Robert Berry. Kjo kartolinë kthehet në një shënim prezantues të një koleksioni të vetëm të bërë bashkë për Galerinë Kombëtare të Arteve nga artisti konceptual, Jan Dibbets. Në 1999-ën, ekzaktësisht 20 vite përpara, këto vepra arti erdhën në Tiranë për të gjetur një situatë specifike psikogjeografike dhe akustike në qytet. Ekspozita që çelët sonte në Galerinë Kombëtare të Arteve rivendos në skenë këtë koleksion, duke adresuar kolapsin e perceptimeve të kohës dhe pikëprerjet mes koleksionit, veprave të artit dhe qytetit të Tiranës. Urimet më të mira për 1999-ën gjen ritmin

e saj përmes kohës. Ekspozita shpalolet përmes një numri të ngjarjeve, përfshirë takime publike, rituale, performanca, diskutime dhe një programi edukativ.

Ekspozita përmban punë nga: Marina Abramoviç/ Pierre Alechinsky/ Giovanni Anselmo/ Karel Appel/ Eduardo Arroyo/ Frank Auerbach/ John Baldessari/ Robert Barry/ Georg Baselitz/ Ross Bleckner/ Stanley Broun/ Günther Brus/ Daniel Buren/ Patrick Caulfield/ Hanne Darboven/ Richard Deacon/ Nicola De Maria/ Christo and Jeanne-Claude/ Jan Dibbets/ Helmut Federle/ Günther Förg/ Leon Golub/ Dan Graham/ Georg Herold/ Damien Hirst/ Jenny Holzer/ Douglas Huebler/ Cristina Iglesias/ Alex Katz/ Mike Kelley/ Mark Kosta-



bi/ Konrad Klapheck/ Joseph Kosuth/ Sol // LeEitt/ Richard

Long/ Sarah Lucas/ Markus Lüpertz/ Brice Marden/ Allan Mçollum/ Guy Mees/ Juan Muñoz/ Mimmo Paladino/ Gilbert & George/ Jaume Plensa/ Ed Ruscha/ Marien Schouten/ Thomas Schouten/ Richard Serra/ Niele Toroni/ Toon Verhoeft/ Didier Vermeiren/ Carel Visser/ Lawrence Weiner/ Jan Voss. Arnisa Zeqo është një historiane arti, kuratore dhe edukatore në Amsterdam. Së fundmi (2015-2017), ajo ka punuar për ekspozitën ndërkombëtare "Dokumenta 14" në qytetet e Athinës dhe Kasselit. Arnisa është përgjegjëse për programet e edukimit (aneducation) në Athinë dhe inicues e Shoqatës së Miqve të Ulises Carrion-it në "Parlamentin e Trupave". Arnisa ka bashkëthemeluar hapësirën e artit

EKSPOZITA

"EVERLAST"


Gjashtë tregime me personazhe të vizatuara gjatë natës

Fatmira Nikolli

Është çelur në "Stacion" - Qendra për Art Bashkëkohor në Prishtinë, ekspozita e artistit shkodran Lek M. Gjeloshi. E kuruar nga Vala Osmani, "Everlast" është ekspozitë, e cila eksplorohet nëpërmes video-instalacionit shumëkanalësh specifik për vendndodhjen, që bazohet në serinë e punëve monokromatike, i bërë gati për rrugëtim nëpër hapësirën e Klubit të Boksit.

Ekspozita zhvilloj një produksion të ri të punëve dhe një proces sfidues për artistin, i cili kërkon hapësirën specifike për të theksuar punën e tij. Monokromatika, e bardha dhe e zeza në punët e Lekës, i heq ngjyrat e realitetit për të krijuar hapësirë për një tonalitet shpirtëror mes soditës dhe fragmentit të soditur, e hulumtuar me "efektet tjetërsuese të hapësirave në limb" (Forbes 2018). "Everlast" çliron imazhe nga kujtesa e afërme dhe e largët, duke këmbëngulur në një ngjyrë të vetme si formë e fundme e paraqitjes, me boksierin si personazh dhe me fuqinë e pafundme të (pa)nohur të pranuar nga hapësira, me artistin i cili qëllimisht eksploron referenca rethore dhe kinematografike për të ndërthurur tregime. Gjashtë tregimet, me personazhet e vizatuara gjatë natës, që përcillen në hapësirë, lëvizin ngadalë ose përpigën të lëvizin, duke sfiduar, duke e përballur, duke ngritur kurthe, për të ndjellë shikuesin. Të zhveshura nga ngjyrat për të luajtur në këtë vendndodhje specifike, akoma me shtresat e ngjyrave ekzistuese, të cilat shënjojnë histori dhe kohë, Klubi i Boksit mirëpret vizatimet e "Everlast" dhe personazhet e saj, ku: Ringu i boksit është prapë i dukshëm. Boksieri në vetmi, godet në zbrazëti. Maca lëvizë brenda dhe jashtë. Era. Tingulli. Nusja. Boksieri i lodhur që bën dush, shkujdesur shtërëngon një shkop bejsbolli. Trupi duke qëndruar në vaskë.


Gratë mitologjike që shikojnë njëra-tjetrën, mbi trupin e boksierit. Personazhet e "Everlast", të ekspozuar në një hapësirë të përjetshme, ringjallen në të, në mënyrë që të mund të vdesin përsëri. Boksieri dhe personazhet e tjera magjepsëse janë aty për të përsëritur, për të zhvendosur, për të shtyrë kufijtë e ngjashmërisë dhe të hapësirës (Sturtevant 2007). Në kulturën popullore, termi "Everlast" është sinonim i boksit, ndonëse kompania e filloi punën si fabrikë për prodhimin e kos-



Artisti Lek Gjeloshi, me ekspozitë në "Stacion" në Prishtinë

tumeve të notit në Bronx (SHBA) në vitin 1910. Në uebfaqen e kompanisë shkruhet që shtatëmbëdhjetëvjeçari Jacob Golomb filloi të prodhonte kostume për të cilat ai garantonte një kohëzgjatje njëvjetore. Ky titull e pozicionon artistin në një raport të mistershëm me të kaluarën e hapësirës së Klubit të Boksit dhe me historitë që provokojnë vizatimet e tij. Hapësira aktivizohet gjithnjë në marrëdhënie me përmbajtjen e veprimeve të njohura e të panjohura. Ajo do jetë e hapur deri më 27 prill. Lek M. Gjeloshi

(1987, Shkodër, Shqipëri) studioi arte vizuale në Akademinë e Arteve të Firences, në Itali (2010). Praktika e tij artistike fokusohet në përpunimin e një intensiteti të veçantë, që çliron mungesa e një objekti të paracaktuar kërkimor. Ndër ekspozitat personale, përmendim: "Sleepwalkers" në galerinë 'Zeta' (Tiranë, 2018); "All my colours turn to clouds" në Villa Romana (Firence, 2016); "Off-cells" në Galerinë e Arteve të Shkodrës (Shkodër, 2016). Në vitin 2016 u shpall fitues i çmimit "Ardhje" për artistët e rinj, organizuar nga TICA - Tirana Institute



of Contemporary Art në Shqipëri. Në 2015-ën ishte fitues i çmimit "Idromeno". Ka marrë pjesë në një sërë ekspozitash

kollektive që nga viti 2007, si: "Ex Gratia", kuruar nga Adrian Paci dhe Risha Paterlini në Collezione Iannacone (Milano, 2018); "A time for dreams", kuruar nga David Elliott në Muzeun e Artit Modern Moskë (Moskë, 2014); "Fuori Posto", "Nuovo Cinema Masacio" dhe "Lontano da dove?", kuruar Pier Luigi Tazzi në Casa Masacio dhe në Fondacionin Lanfranco Baldi (Firence, 2014, 2013, 2012). Në vitin 2018 ishte artist në rezidencë në "Residency Unlimited", Nju Jork. "Everlast" e artistit Lek M. Gjeloshi u mbështet nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës, Komuna e Prishtinës, x-print dhe DZG.

RESHAT ARBANAPROBLEME ME ZEMRËN, SHTROHET NË SPITAL



Aktori i njohur Reshat Arbanaprobeme është shtuar në spital ditën e mërkurë. Lajmi në media ka dalë dhe i konfirmuar nga burime spitalore. Të njëjtat burime thonë se Arbanaprobeme mban prej kohësh zemrën në kontroll pas një 'by-pass'-i të kaluar. Pas dy ditësh në spital, gjendja e tij shëndetësore është stabilizuar, por ai vijon të mbahet nën vëzhgim dhe mjekëve. Për shkak të problemeve shëndetësore, ai është shtuar me urgjencë në pavionin e Kardiologjisë në QSUT. Ikonat e skenës shqiptare, Reshat Arbanaprobeme, ka festuar 78-vjetorin e lindjes vitin që shkoi. Ditën e festës ai tha se asnjëherë nuk i ka festuar përveç të tjerës, sepse nuk i do. "Më krijojnë emocione shumë të mëdha, por sonte po më duket krejt ndryshe. Për burrin qenka trimëri e madhe të bëhet 78 vjet, e të ecë nga 80-ta, por na qenka

edhe një mjerim i madh, kur mendon se ku do iki pas këtyre viteve që po kalojmë. Po ishalla në atë dynja, do shkojmë tek ai vendi i mirë, jo tek ai i keqi. Faleminderit shumë, ju jam shumë mirënjohës, jashtëzakonisht faleminderit! Kam emocione shumë, më besoni që kam shumë emocione. Por, ju falënderoj shumë me gjithë zemër dhe ju shpërblefsha që të gjithëve në gëzime, në festa nëpër familjet tuaja", që shprehur Arbanaprobeme. Reshat Arbanaprobeme lindi më 1940 në Tiranë. Ka mbi 35 role në kinematografi, brilant në karakteret që ai shpreh,

si në rolet negative, edhe ato pozitive.

I jep frymë e shpirt rolit dhe pjesë nga e vetja e vet më shumë se ngjizet në atë rol, i jep fizionominë e vet, pasi për këtë legjendë të artit shqiptar nuk ka ndalje, ai jep gjithçka për artin. Studimet e larta i kryen në vitin 1968. Fillimisht punon në radio, më pas vitit 1977, aktor i Teatrit Kombëtar dhe i kinematografisë shqiptare. Ndër rolet më të spikatura në film është Samiu tek "Fije që priten" 1976. Isa Boletini është një nga rolet që i shkon më për shtat aktorit të madh Reshat Arbanaprobeme në filmi "Nëntori i dytë" në vitin 1982, prefekti tek "Gjeneral gramafoni" 1978, Bimbashi tek "Liri a vdekje" 1979, Ahmeti tek "Dora e ngrohtë" 1983, Adnani tek "Hije që mbeten pas" 1985, Aliu tek "Bi-

narët" 1987, Emili tek "Rikonstruksioni" 1988, Kuke Memini tek "Balada e Kurbinit" 1990. Për rolet e Dajlan Beut tek "Kush vdes në këmbë" 1984 dhe Kryetarit të Këshillit tek "Kur hapen dyert e jetës" 1986 ka fituar Medalionin e Festivalit të Filmit më 1985 e 1987. Më 7 tetor 2011 Presidenti i Republikës, Bamir Topi, i akordoi zotit Reshat Arbanaprobeme "Nderi i Kombit" me motivacionin: "Aktorit të shquar të teatrit dhe kinematografisë, i cili me interpretimin mjeshtëror dhe originalitetin e tij u bë një artist popullor e shumë i dashur për publikun, rolet e të cilat kanë pasuruar me vlera të reja kulturë kombëtare". Në 21 nëntor të 2018 ai fiton çmimin aktori i vitit tek Çmimet Kult me rolin e babait tek "Babai".

Drejt "Exit" nga Brexit?

Nga Jorgji Kote

(villon nga faqja 1)

... të përzgjedhura lidhur me daljen nga BE-ja, duke përfshirë edhe atë pa marrëveshje. Ishte një votim i çuditshëm, ku sipas shtypit të huaj, secili ishte kundër secilit dhe të gjithë kundër të gjithëve dhe të gjithave! Meqenëse ky votim nuk është i detyrueshëm për qeverinë, May është e vendosur ta kalojë për herë të tretë dhe të fundit në votim marrëveshjen me BE-në. Ajo nuk hezitoi që të shpallë dorëheqjen nga politika, me kusht që marrëveshja të miratohet javën e ardhshme. Pavarësisht efekteve pozitive që kjo pati në rritjen e mbështetjes, do të thënë se veç kundërshtarëve brenda radhëve të veta, qeverinë e pakicës, këtë e ka në dorë aleatja e saj me 10 deputetë, DUP-ja e Irlandës së Veriut. Liderja e saj, Foster, konfirmoi edhe pas të "Jo"-ve kundërshtimin e saj kategorik.

Për pasojë, veç zëvendësimit të May dhe zgjedhjeve të parakohshme, tani Britanisë së Madhe i mbeten vetëm dy alternativa: një Brexit pa marrëveshje (No deal) e mbaruar me kaos dhe pasoja të paparashkueshme për Britaninë e Madhe dhe BE-në, ndonëse kjo e fundit po merr të gjitha masat për minimizimin e tyre. Alternativa tjetër më e mundshme mbetet referendumi i dytë lidhur me Brexit, por gjasat janë që ai të kthehet në një "exit nga Brexit", pra dalje nga Brexit e jo nga BE-ja. Kjo duket si lojë fjalësh, por në fakt përfaqëson një realitet dhe sfidë tejet të vështirë; zaten kështu ndodh kur çështje kardinale të një vendi të madh dhe në kohë të turbullta stuhish tentohet t'u jepet zgjidhje thjesht dhe vetëm me një "Po ose Jo", ose "të shkojmë apo të qëndrojmë?" (go or remain) në një referendum si ai i 23 qershorit 2016.

Referendumi i dytë, si alternativa më e mirë nuk është "wishful thinking" dmth., vetëm dëshirë e mirë, por një kërkesë dhe alternativë e domosdoshme për Britaninë dhe Evropën. Këtë e tregoi veç të tjerash prania e mbi një milion vetave në protestën më të madhe në historinë e këtij vendi javën e kaluar në Londër. Po ashtu, petitionin online për këtë referendum e kanë nënshkruar brenda një jave mbi 6 milionë veta, shifër që sa vjen dhe rritet. Sipas sondazhit më të fundit, në favor të përsëritjes së këtij referendumi janë 56 për qind e britanikëve. Shumë e rëndësishme politikisht, pas disa luhatjeve, më në fund shumica e deputetëve laboristë në opozitë janë pro tij. Dhe në votimin e parë, kjo alternativë pati diferencën më të ngushtë pas bashkim-it doganor.

Me të drejtë deri tani përsëritja e referendumi është refuzuar, pasi kishte probleme lidhur me respektimin e vullnetit demokratik të shumicës, dmth., atyre që votuan pro Brexit dhe të krijimit të një precedenti negativ për të ardhmen.



Mirëpo kjo ishte e vlefshme deri në momentet e tanishme, por jo më tej, për disa arsye thelbësore që përmenden shkurt më poshtë.

Së pari, vullneti demokratik i shumicës është respektuar plotësisht nga të gjithë dhe nga BE-ja. Fill pas fitores së Brexit, dha dorëheqjen nisimtare i tij, ish-kryeministri Kameron dhe disa ministra të qeverisë së tanishme; janë dorëhequr edhe vetë liderët e tij, që mesa duket domin t'i "nxirrnin gështenjat përvëluese me mashën e të tjerëve". etj. Në vijim, gjatë gati tri viteve të fundit pas referendumi të 23 qershorit 2016, Britania dhe BE-ja kanë zbatuar lloj-lloj programesh dhe projektsh. Ato kanë ndër marrë demarshe të panumërta, shoqëruar me një valë dorëheqjesh, duke përfshirë dhe tre sekretarë shteti këtë javë dhe ecejake diplomatike pa fund për të gjetur dritare dhe shtigje daljeje me BE-në, por më kot. Sipas "The Economist", May ka premtuar 108 herë se më 29 mars, Britania e Madhe do të dilte nga BE-ja, por u detyrua të bënte të kundërtën më 20 mars me letrën drejtuar presidentit të Këshillit Evropian, Donald Tusk, ku kërkoi shtyrjen e kësaj daljeje. Nga ana e vet, BE-ja është treguar e gatshme dhe luajale, duke pranuar shtyrjen e afatit deri vitin e ardhshëm dhe duke bërë aty këtu lëshime ndonëse kozmetike, sepse marrëveshja e saj e "qëndisur" nga Michel Barn-

ier konsiderohet "vepër arti", ndaj, tejet e vështirë, për të mos thënë e pamundur; që asaj t'i lëvizësh goftë edhe një presje.

Të gjitha këto hapa dhe veprime në respekt të vullnetit të shumicës, në favor të Brexit janë ndër marrë kur po mbushen gati tri vite pas fitores së Brexit. Kur me gjithë shpresat e euroskeptikëve, me gjithë rezervat dhe kundërshtitë në disa vende, asnjë shtet tjetër nuk është i gatshëm të ndjekë shembullin e Brexit. Ndërkohë, kanë dalë vazhdimisht fakte të reja, që hedhin dritë mbi morinë dhe seriozitetin e sfidave dhe vështirësive të krijuara e që do të shtohen pas Brexit në të gjitha fushat, në radhë të parë për Britaninë e Madhe, por edhe për të tjerët. Bëhet fjalë për pasojat e pallogaritshme pas daljes nga BE-ja në të gjitha fushat e sidomos për brezin e ri, investimet, punësimin, lirin e lëvizjes, sponsorizimin e kontakteve kulturore, shkencore dhe njerëzore që ndihmohehin shumë falë programeve të mirënjohura të BE-së. Mjafton të përmendim shqetësimin që ngritën në letrën e tyre para dy muajve 4000 rektorët e universiteteve britanike. Pa hyrë pastaj në rrezikun që i kanoset sërish paqes ndërmjet dy Irlandave me histori të shumta konfliktesh të armatosura. Ndërkohë, sic pohojnë shumica e ekspertëve, edhe BE-së nuk i intereson një Britani e Madhe jashtë saj, si ekonomia e pestë më e madhe në botë, antare e përhershme e KS të

OKB-së, me traditat e famshme anglo-saksone, sigurinë etj.

E me gjithë këto përpjekje, Britania e Madhe nuk po gjen dot dalje nga BE-ja, madje kjo është kthyer në një dramë tragjike të formuarit të Shekspir. Këto tri vite janë të mjaftueshme për të dëshmuar se shumica pro Brexit bëri sipas fjalëve të presidentit të Këshillit Evropian, Donald Tusk, "një gabim tragjik" dhe përfaqësuesit e saj e treguan veten tërësisht të paafte për të realizuar këtë projekt. Ndërsa, siç u pa edhe më lart, koha po tregon se pakica kundërshtarë e Brexit, që është rritur vazhdimisht dhe në numër kishte të drejtë. Kësaj, politika britanike dhe BE-ja nuk i kanë më asnjë borxh elektoratit pro Brexit, sepse ia bënë të gjithë "hyzmetin".

Pas këtyre argumenteve bindëse, mbetet për t'u shtjelluar aspekti politik, juridik dhe organizativ i përsëritjes së referendumi. Këtu çështja kryesore shtrohet nëse lejohet në demokraci që dikush goftë edhe një shumicë apo pakicë të ndryshojë një ide, mendim dhe preferencë politike etj.? Ca më tepër për një çështje madhore e me pasojat për të ardhmen si dalja nga BE-ja? Përgjigja është pohuese, po, lejohet, madje ndryshimi dhe korrigjimi i një ideje apo mendimi të dikursit, kur koha dhe kushtet nuk e lejojnë ose mundësojnë është element i përhershëm në demokraci, sidomos kur praktika i nxjerr "jashtë lojë". Atëherë, si

mund t'u mohosh këtë të drejtë një pjesë shumë të madhe e në rritje të popullsisë që është kundër Brexit? Po dhe vetë një numër i madh britanish, kush mund të thotë se nuk janë penduar dhe nuk janë kthyer në krahun tjetër?

Mbi të gjitha, dhe nga ana ligjore/juridike nuk ka asnjë problem, sepse Gjykata Evropiane e Drejtësisë është shprehur qartë se tërheqja nga Brexit është një vendim që i takon Britanisë së Madhe, pa miratimin e BE-së. Gjithsesi, për këtë duhet domosdoshmërisht një referendum i dytë për të certifikuar edhe politikisht vullnetin e popullit nëpërmjet votës demokratike.

Përgjigja është pozitive dhe ndaj pyetjes "po sikur të fitojë sërish Brexit, çdo të ndodhë"? Kjo është një pyetje absolutisht hipotetike dhe e pamundur të ndodhë për shkak të që u përmendëm më lart. Praktikisht, si do t'i përgjigjen britaniasit pyetjes asgjësuese "ju lamë plot tri vite, bëtë ç'dëshët, ç'kërkonti më"? Aq më tepër që ihtarë e Brexit, Boris Johnson, Farage etj., janë diskredituar keq dhe nuk kanë më guxim të udhëheqin një fushatë të dytë pro Brexit. Gjithashtu, përsëritja e këtij referendumi nuk përbën kurrfarë shqetësimi për krijimin e ndonjë precedenti negativ për demokracinë në të ardhmen. Shmangia në të ardhmen e këtij precedenti kërkon në radhë të parë dhe mbi të gjitha kujdes, analiza për kostot dhe përfitimet e vërteta dhe përgjegjësi nga klasa politike britanike dhe gjeteke.

Dhe nga pikëpamja praktike/organizative, referendumi i dytë është më i lehtë e pa kosto për t'u realizuar, për më tepër se BE-ja ka pranuar shtyrjen e afatit të daljes nga BE-ja deri në maj 2020. Në fakt, shkakun dhe arsyeja kryesore për këtë qëndrim elastik të saj është pikërisht që të ketë kohë të mjaftueshme deri në krijimin e kushteve të nevojshme për referendumin e dytë, nëse dëshirojnë alternativat e tjera të mbetura, sikurse janë dhe gjasat.

Së fundi, vetëkuptohet se dëshitimi i Brexit është ogur i keq për popullsitë dhe euroskeptikët, nga një prelude fitoreje në shkallë evropiane, ai po kthehet në një katastrofë të paralajmëruar. Por, ai është padyshim lajm i mirë për forcat progresive dhe demokratike, për një Evropë më të mirë dhe më shumë "frymë", aq më tepër tani në prag të fushatës së zgjedhjeve të reja evropiane, si mundësia e parë madhore për të shënuar kthesën dhe fitoren e projektit të reformuar; që në vend të dukurisë "Brexit" për BE-në, të ketë vetëm reformim, thellim dhe zgjerim të mëtejshëm e sa më shpejt edhe drejt Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë. Sepse, vetëm me një "exit" nga Brexit dhe jo nga BE-ja, dilemat e tij të shumta hamletiane nuk do të jenë më një makt makbethian, por një odë gëzimi bethovian. Ndaj, Evropa do t'i thotë ngrohtësisht Britanisë së Madhe "Welcome back home".

Opinion *i* Ditës

Për Li Memën, kolosin e futbollit shqiptar...

Nga Rezarta Delisula

(vijon nga faqja 1)

... E mbaj mend që për së vogli, me mjetin e tij të përherëshëm, biçikletën, që s'e ndau deri sa sëmundja e kaploi në shtrat. Kur shoja të lozja me shoqet e mia pranë shtëpisë së tij, përballë klinikës iraniane, admiroja Liun dhe Lizën (zyshën time të fizikulturës). Një çift simpatik, të qeshur, që shpesh edhe na këshillonin si duhej të loznim me top. Babi më tregonte ndërkohë se sa i madh ishte Ali Mema, më tregonte për 4 kampionatet e fituara nga bardheblutë në vitet '60-'70, ku Ali Mema ishte mesfushor, për Kupën e Shqipërisë fituar po nga ekipi i Tironës, por edhe fitoret e korrura kur ai ishte zëvendëstrajner. E pikërisht nga ky njeri, legjenda e futbollit shqiptar, unë merrja këshilla. Djalit i përçoi dashurinë për sportin e sot Ard Mema është trajner i Tironës, ndërsa kujtoj Almën vajzën e tij, që rrinte gjithë kohës duke studiuar. Ikja e parakohshme e gruas së tij të bukur, Lizës, duket se e dërrmoi kolosin e futbollit, megjithatë ai gjeti forca të fëmijët e tij. Herën e fundit që e takova Ali Memën ndenjëm gjatë, të tre, bashkë me babain tim. Erdhi si zakonisht në kafe me biçikletën e tij. Edhe pse te të 70-tat, më dukej i pandryshuar, ashtu siç ia kisha konturuar pamjen kur isha ende fëmijë. Fliste pa fund për vajzën dhe fëmijët e saj dhe për Ardin, që e kishte djalin pas shpirtit. Që nga ajo ditë, që përkon me rreth 2 vite e gjysmë më parë, nuk e shihja më rrugicave të lagjes sime në Pazarin e Ri. Kur Presidenti i Republikës i akordoi një çmim të madhit Skënder Halili dhe ekipit të Tironës së viteve '60-'70, pyeta për të. Më thanë që është sëmurë dhe nuk ngrihet dot nga shtrati. Doja që atë ditë, një titull vlerësimi nga presidenti t'i shkonte pikërisht Ali Memës, sa ishte gjallë, e ky titull mbase do ta ndihmonte duke ia mbushur shpirtin me kujtime të bukura e shpresë. Të mërkurën e 27 marsit nuk do ta besoja, ta shihja shtrirë të pajetë, mbuluar me lule dhe lotët e familjarëve dhe shokëve të tij të skuadrës. Mu dhimbsën ata burra, që kishin kaluar një jetë me mikun e tyre të mirë, e në sytë e përletura shihje shumë dhimbje. Kalova para tij, ndërsa trupin ma përcuan mornica. Një kampion nuk duhej të ishte kaq shpejt. Një njeri i mirë si Liu i duhej ende këtij mleti. Vendosa të instaloj në memorien time imazhin e tij për së gjalli, me flokët kaçurrelë të zinë dhe trupin e gjatë e të drejtë. Me sytë e qeshur dhe gojë që i fliste vetëm mirë. Ali Mema nuk ishte vetëm kolosi i bardhebluve, por legjendë e futbollit kombëtar shqiptar. E paç dheun e njëri i urtë!



Herën e fundit që e takova Ali Memën ndenjëm gjatë, të tre, bashkë me babain tim. Erdhi si zakonisht në kafe me biçikletën e tij. Edhe pse te të 70-tat, më dukej i pandryshuar, ashtu siç ia kisha konturuar pamjen kur isha ende fëmijë. Fliste pa fund për vajzën dhe fëmijët e saj dhe për Ardin, që e kishte djalin pas shpirtit. Që nga ajo ditë, që përkon me rreth 2 vite e gjysmë më parë, nuk e shihja më rrugicave të lagjes sime në Pazarin e Ri. punën që ata bëjnë kundër ndotjes së ambientit. supermacistëve të bardhë, ka të njëjtën formë dhe pasoja.

HOROSKOPI

DASHI

Këtë të premte do të ngarkoheni me detyra të pafundme. Fundjava juaj do të varet nga rezultati i kësaj dite. Përqendrohuni te puna dhe mos shpenzoni kohë me komunikime telefonike të kota apo lundrim në internet.

DEMI

Rrezikoni të humbisni mbështetjen e një personi që e konsideroni mik të ngushtë. Tregoni kujdes në marrëdhëniet me ata që keni për zemër. Rekomandohet të tregoni kujdes edhe në çështjet e punës apo financat tuaja.

BINJAKET

Shumë Binjakë rrezikojnë të mos kenë njohuri për një çështje me rëndësi sot. Kjo gjë do të shkaktojë grindje me një mik të mirë. Shmangni ofendimet dhe përpikuni të sqaroheni, pasi rrezikoni t'i jepni fund përgjithmonë marrëdhënies suaj.

GAFORJA

Mos i keqkuptoni kritikën e të afërmeve tuaja, qëllimi i tyre është pozitiv. Sot ka një shans që rrethanat të mbështesin zbatimin e qëllimeve tuaja. Kushtojuni vëmendje të veçantë ndjenjave dhe mos lejoni që xhe-lozia të hyjë në martesën tuaj.

LUANI

Për Luanët kjo ditë premtori liri dhe lehtësi. Fati do të mbështesë idetë tuaja të planifikuara për këtë ditë. E vetnija gjë që mund të erresojë triumfin është zila e dikujt afër jush. Ndoshta mundësia juaj më e mirë është zbejha e komunikimit me 2 ose 3 persona në shoqërinë tuaj.

VIRGJERESHA

Për të lindurit e kësaj shenje, kjo ditë nuk do të jetë më e mira sa i përket suksesit. Ekziston rreziku që miqtë, rrethanat e padëshiruar apo indiferenca të ndërhynjë tek ju. Gjithashtu, mosmarrëveshjet me fqinjët janë të mundshme të ndodhin sot.

PESHORJA

Për Peshoret, kjo e premte do të sjellë kënaqësi dhe lumturi sa i përket jetës personale. Mund të pajtohemi me dikë, me të cilin keni ndërprerë lidhjet. Ish-marrëdhënia juaj mund të kthehet përsëri. Bëni kujdes me financat.

AKREPI

Ka shumë mundësi që këtë 29 mars Akrepat të kenë probleme në komunikim me bashkëshortin ose kolegun tuaj, duke bërë që të lindin mosmarrëveshjet. Megjithatë, kjo situatë do të jetë e përkohshme dhe shumë shpejt do të rikthehet normaliteti.

SHIGJETARI

Shigjetarët do të surprizohen nga një event që e prisnin prej kohësh. Mund të nisni një punë të re, të zgjidhni problemet personale ose të kaloni deficitin financiar. Mos besoni gjithçka rreth vetes suaj, madje as me personat që ju i besoni më shumë.

BRICJAPI

Disa Bricjapë mund të tentojnë t'i përshtrihen në shtëpi rezeje. Ekziston një gjë e mundshme për t'u bërë plani tuaj, madje edhe më parë seç mund ta kishit menduar. Kohën e re do të shprehë udhëzimet e familjes. Në rimbaje do të jeni pranë personit të zemrës suaj.

UJORI

Disa Ujorë nuk do të ndalen nga asgjë vetëm për të realizuar qëllimin e tyre. Megjithatë, bëni kujdes se mund të shkelni normat morale. Nëse keni vepruar gabim në ndonjë moment, përpikuni ta korrigjoni atë sa më shpejt të jetë e mundur.

PESHQIT

Sot Peshqit nuk duhet të kundërshtojnë opinionin e skuadrës së tyre. Ndoshta nuk do të jeni në gjendje ta fitoni këtë luftë. Është e rëndësishme të vlerësoni edhe mendimin e të tjerëve. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.

TRAJNERI I KUKËSIT

Sfida direkte kundër Partizanit është rëndësishme, por jo vendimtare në garën për titullin kampion. Me këtë ide fikse, por me shumë optimizëm, Ramadan Ndreu pret debutimin e tij në bankinë e Kukësit. Tekniku zëvendësoi Armando Cungun, ndërsa fati i rezervoi një ndeshje kundër rivalëve më të mëdhenj.

"Është ndeshje e një rëndësie të veçantë, pasi ata kanë qenë në krye gjatë gjithë kampionatit. Kemi avantazhe dhe jemi më të etur për të marrë pikët. Duke krahasuar të dyja ekipet, shoh më shumë mobilizim për fitore. Do të duhet shumë punë", ka thënë Ndreu në konferencën për mediat përpara sfidës së të premtës në "Loro Boriçi". Diferenca prej nëntë

Ndreu ul presionin: Nuk është sfidë vendimtare

pikësh në tabelën e renditjes duket se transferon presionin për fitore te Kukësi, por trajneri i skuadrës verilindore nuk ndan të njëjtin mendim. Për Ndreun, kampionati mbetet i hapur edhe pas kësaj përballjeje. "Gara për titull është e hapur derisa

e lejon matematika, nuk kemi presione. Ua kam thënë futbollistëve të tregojmë se jemi të mirë jo vetëm në letër", ka vijuar më tej trajneri i Kukësit. Ndreu nuk mund të evitonte një koment në lidhje me polemikat që kanë shquar vigjiljen e sfidës dhe

që kanë të bëjnë me çmimet e biletave. "Jemi munduar për fushën, nuk ishte strategji. Në Elbasan nuk është fusha e mirë, në Shkodër është më e mirë. Po të isha tifoz, do ta blija biletën 10 mijë lekë". Kapiteni Shemeti dhe Ethemij janë dy mungesa të rëndësishme për Kukësin, por lajmi i mirë për verilindorët është rikthimi i Valdet Ramës dhe brazilianit Kordeiro.

Tjetër dëmtim te Partizani, Kukësi "fërkon" duart

Situata ka kthyer në smënyrë të pabesueshme. Dy javë më parë ishte Kukësi me shumë probleme dhe me gjysmën e ekipit jashtë, në prag të përballjes me Partizanin kryesues. Por, bojkoti i arbitrave u ka dhënë një dorë të madhe verilindorëve, që kanë arritur të rikuperohen të gjithë të dëmtuarit dhe të jenë në formë maksimale për ndeshjen më të rëndësishme të sezonit, e cila do të mund t'i rikthente në korsinë e titullit në rast suksesi. Por, kjo gjë nuk mund të thuhet për Partizanin. Të kuqtë kanë humbur shërbimet e Bruno Telushit, i operuar së fundmi, Rubin Hebjajt të dëmtuar, Dilaver Dukës të dëmtuar dhe Lum Rexhepit të skuadrikuar, ndërsa në dyshim të fortë është edhe Jurgen Bardhi. Por, sikur të mos mjaftonin këto, në seancën e djeshme stërvitore probleme ka shfaqur edhe Esat Mala, që ka kryer disa vrapime i diferencuar nga grupi, çka i shton jo pak telashet për Skënder Gegën në prag të ndeshjes së sotme.

Çmimi i biletave, trajneri është i prerë: Edhe në Bangladesh do të na ndjekin tifozët tanë



Jeton Selimi

Gega: Smë shqetësojnë mungesat, në "Loro Boriçi" do të jemi në shtëpi

Kryendeshja e sotme kundër Kukësit, Partizani është gati

Skënder Gega beson te suksesi në sfidën e sotme ndaj Kukësit, pavarësisht se skuadra e tij vjen e përgjysmuar për shkak të dëmtimeve të titullarëve. Trajneri i Partizanit deklaroi se e ka grupin në gjendje të përballojë një sfidë titulli me Kukësin, pavarësisht problematikës. Ai beson te mbështetja e tifozëve, pavarësisht se Kukësi ka luajtur me çmimin e biletës, duke e çuar në 10 mijë lekë të vjetra për një sfidë të tillë.

Shumë mungesa për këtë sfidë, sa të gatshëm jemi?

Kemi marrë maksimumin në 2 ndeshje, por është e kaluar. Ndeshja nesër është e rëndësishme. Kemi ardhur pas një periudhe pushimi, kemi pasur probleme, siç është dëmtimi i Telushit, që është një nga pikat më të forta tona. Edhe Idrizaj gjithashtu pak më parë. Javën që kaloi patëm 2 mungesa të tjera, Hebjaj



dhe Bardhi. Bardhi po rikuperohet, të shikojmë nëse do të jetë gati. Jemi

gati me gjithë mungesat që kemi. Do të shikojmë në Shkodër për më të mirën,

jemi në vend të parë, 9 pikë larg. **Ju shqetëson mes-**

fusha?

Prandaj klubet kanë një listë prej 25 vetash, sepse merren parasysh të gjitha, edhe kundërshtarët kanë pasur mungesa. Ardha e Hilës i ka dhënë ekipit konfidencë. Kur mungonte, e kemi zëvendësuar me Atandën, që ka bërë mirë. E rëndësishme është të kemi të njëjtin performancë. Kemi arritur të jemi këtu ku jemi falë këtyre.

Kush e zëvendëson Telushin?

Ka emra në ekip. Çdo njeri rritet. Ky është futboli. Do të mundohemi ta kompenzojmë, grupi i ka forcat. Nuk mund të them asgjë më përpara se kush do të jetë 100%. Djemtë stërviten mirë, për mua kjo është e rëndësishme.

Lojtarët e ardhur në janar nuk po aktivizohen...

Edhe tek ekipet e tjera, lojtarët nuk janë ingranuar me shpejtësi të madhe, përveç Rexhepit. Lojtari tjetër që është mesfushor ka pasur probleme fizike, kemi edhe një fazë të katërt, shpresoj të bëhet sa më shpejt.

Rexhepi ka një karton për ndeshje, ju shqetëson?

Më shqetëson, por nuk ndryshojmë diçka. Mënyra si luan është pak agresive, por nesër nuk do të jetë. Mbas kësaj ndeshjeje do të jetë në grup.

Kukësi vjen me trajner të ri.

Nuk është problemi im, nuk futem për t'i prishur planet e tyre. Do të mundohem të marr më të mirën në fushë. Zgjedhjet e klubeve të tjera janë planet e tyre. E rëndësishme për mua është të

Çmimi i biletave ka qenë temë dite së fundmi.

Jam pyetur çdo javë për batutat e klubeve, por dorëzohem, nuk i përket futbollit. Mënyra si i administrojnë biletat është punë e tyre. Nuk na interesojnë biletat. Edhe në Bangladesh të na çojnë, Partizani do të ketë tifozë. Edhe jashtë shtetit klubi na ka mbështetur. Nuk ka shans që asnjë ekip të ketë më shumë tifozë se ne. "Loro Boriçi" të jep adrenalinë për të luajtur. Ne do të jemi si në shtëpi.

Do të ishit dakord që klubi të bënte të njëjtin gjë ndeshjen e ardhshme?

Hakmarrja nuk është pjesë e mirë. Në këtë ekonomi, çdo biletë është e tepërt në Shqipëri. Do të doja që të vijnë falas, pa bileta. Nuk kam të drejtë të ndërhyj. Dua të mbushen stadiumet, edhe tonat edhe të kundërshtarëve.

Partizani kishte 4 futbollistë me ekipet kombëtare.

Për fat të mirë është e kënaqshme. Kanë udhëtuar, por janë mirë. Është pozitive për ne, rrallë ndodh për një klub nga Shqipëria.

E mendoni veten tuaj si kandidat për Kombëtarën?

Kam qenë trajner i Kombëtares. Tani jam i Partizanit. Është po aq i madh dhe jam fokusuar këtu. Dëshirat të opinionerit janë të ndryshme. Do të jem këtu 100% sa të mbarojë.

ISH-DREJTORI

Vitale: Hysaj nuk do të rinovojë me Napolin

Eliseid Hysaj nuk do të rinovojë me Napolin. Ndonëse prej ditësh mediat italiane gëlojnë në informacione sa i takon zgjatjes së kontratës së mbrojtësit kuqezi të ekipit të drejtuar nga Karlo Anceloti, diçka e fillë duket se nuk do të ndodhë. Ai që e zbulon prapaskanen është Pino Vitale, ish-drejtori i Empolit, ekipit ku Hysaj shkëlqeu përpara se të kalonte te Napoli. "Kam parë që në këtë sezon, që pas ardhjes së Malkuit, ka pasur më pak hapësira. Për mua është lojtar që duhet mbajtur në ekip, por nuk besoj se do të rinovojë, kjo pasi e njoh De Laurentis-in. Nëse vjen ndonjë ofertë konkrete, ai do ta lërë Hysajin të ikë. Natyrisht që ky është vetëm opinionimi im", tha Vitale.




Sulmuesi tërhiqet nga Kombëtarja

Higuain: Koha t'i them "lumtumirë" Argentinës

Sulmuesi i Çelsit, Gonzalo Higuain, ka konfirmuar se nuk do të jetë më i disponueshëm për ekipin kombëtar, pasi është lënë jashtë skuadrë që pas dështimit në Kupën e Botës. Higuain ka krisur marrëdhëniet me shokët e ekipit, sidomos pas rasteve të humbura në finalen e vitit 2014 dhe situatave të Botërorit të Rusisë. Goli i tij i fundit për Argentinën është shënuar në vitin 2016 në një ndeshje eliminatorie të vlefshme për Kupën e Botës kundër Perusë, ndërsa në Rusi nuk arriti të gjejë asnjë gol, me "albicelesten" që u eliminua në 1/8-a nga fituesit e veprimtarisë, Franca. "Mendoj se ka ardhur koha që të them 'mjaf'. E kam menduar gjatë këtë vendim dhe mendoj se është koha që unë të tërhiqem. Dua të shijoj më shumë familjen. Për lumturinë e shumë njerëzve dhe mbase për mëzinë e të tjerëve, koha ime ka mbaruar. Tani nuk keni përse të shqetësoheni më do të jem unë në fushën e lojës apo jo", tha Higuain.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Henri që qe piktor.
- Janë si këshjtjella
- Maident që këndonë.
- Janë enë benzine
- Eshtë melodramë.
- Eshtë vegël.
- Gjysmë sterile.
- Janë mallkime shkishëruese.
- Ishte zogu simbol i Jezu Krishtit.
- Ai dhe ajo.
- Janë sëmundjet që përhapen.
- Gjëja e romakëve.
- Shenjtorja që iu pre koka.
- Camus që shkroi I huaji.
- Fillojnë ilustrimet.
- Dieta pa ekstreme.
- Ndërmarrje Autonome Sarandë.
- Mund të jenë postare.
- Ekstreme në sirtar.

- I mungon asaj që i ka kaluar koha.
- Një ekip... anglez
- Ente Ekonomike Rajonale.
- Një llahtar.
- Transporton edhe maune në det.
- Quinn aktor.

VERTIKAL

- Fillojnë mirë.
- Nuk i tregohen babait.
- Në hyrje të tokës.
- Gruaja e dytë e Atamanit.
- Merren në bllok
- Kalimi në kufij
- Qe burri i parë.
- Frolich e Marlene Dietrich.
- Kanë aderuar në parti.
- Shteti pa shi.
- Një pjesë e etiketës.
- Një pellg.

- Janë kundërshtarë në gjyq.
- Eshtë pije e jona.
- Luhen me 1, X, 2
- Mbretëria e Pirros.
- Braktisi Didonën.
- Emri tjetër i Esaut.
- Një pjesë e territorit.
- Një copë për xhepa.
- Janë patriotë të Chopin.
- Ray aktor.
- Mund të jetë solemn
- Alessandro, bomber te Juventus.
- Ylli i Londrës
- Sapo fillojnë
- Emri i Mondrian.
- Kufizojnë katete.
- Lindi Isakun.
- Thurman aktore.
- Në mes të Tommy dhe Jones aktor
- Harris aktor.
- Një rajon kur s'është ajo.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Gardner që qe aktore.
- Në krye të bashkisë .
- Emër vajze.
- Fillojnë pushimet.
- Janë si biskota
- Të fundit në ditar.
- Janë trupa pa kënde.
- Fillojnë notimin.
- Në radhë të parë.
- Pak latinisht.
- Eshtë gjendje të fikti.
- Eshtë vërtet e mërziqshme.
- Një mund të jetë fetar
- Gjysma e sallës.
- Pak dorështrënguar.
- Rastisin në krye.
- Një... dollar.
- Një pjesë e etiketës.
- Skuadra e Moratti-t.
- Ego... ime.

VERTIKAL


- Eshtë sport me stil të lirë.
- Ekstreme ekstremi.
- Një mbishkrim në kryq.
- Kanë bërë piktoreskë të tillë.
- Një vendis autokton.
- Argento aktore.
- Një Behar, aktor komik.
- Ka tre muaj
- Një fjalë si asnjëherë .
- Në krye të armiqve.
- Janë legjenda.
- Flet për të bukurën.
- Një thirrje me emra.
- Vulosen të parat
- Këndojnë me zë të trashë të tillë
- Një mund të jetë armë.
- Mbyllin fushatat
- Një grimcë me bërthamë.
- Dacia shkrimtare
- Eshtë lloj papagalli
- Fillojnë afrimin
- Kapet një me fishkëllimë.
- Mbahet në mbledhje.
- Ekberg aktore.
- Janë zbururime.
- Janë diletantë
- Janë zonat e kufizuara
- Janë tallësit.
- Fillojnë temën
- Një gjë.
- Bëhen për të mirë
- Eshtë shtet aziatik.
- Inicialet e Nolte aktori.
- Shkruhet në janar.
- Teliti regjisor.
- Një pjesë e dramës.
- Rastet pa set.
- Inicialet e Penn aktori.
- Të fundit në studim.
- Kufijtë e rritjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



SUDOKU

			3				5	
			4				8	
	7	8						1
			4	6		8		2
1	5							
	3		5	4				7
		1			4	2		
	8					3		
					5			8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	7	5	2	1	8	4	3	9
4	8	2	9	3	5	7	1	6
9	1	3	4	6	7	5	2	8
1	9	8	5	2	3	6	7	4
2	4	6	1	7	9	8	5	3
3	5	7	6	8	4	1	9	2
5	3	4	7	9	6	2	8	1
7	2	9	8	4	1	3	6	5
8	6	1	3	5	2	9	4	7

Argëtim filozofik

- Njohurinë e pasaktë gjithmonë e ndjek një vendim i gabuar.
- Ateistët janë njerëz të veçantë. Duhet më shumë besim për t'u bërë ateist se sa fetar.
- Pothuajse të gjithë ateistët kanë argumente për bindjet e tyre. Pothuajse asnjë fetar nuk ka argumente për bindjet e tij.
- Ai që ka një mijë miq, shumë herë përpiqet për t'i gjetur ata. Ai që ka një armik, e gjen kudo.
- Përvoja është një mësues i keq, sepse së pari ju vë në provë dhe pastaj ju jep një mesazh.
- Lavdia është si rrethi në ujë. Vazhdimisht zgjerohet deri sa humbet.

Thënie të mençura

- Kur "qan" një ikonë bizantine, të gjithë nxitojnë ti afrohen asaj. Pjesë veten se sa e bëjë të njëjtin gjë kur qan një njeri?
- Nëse ju gjithmonë thoni të vërtetën, nuk keni nevojë të mbani mend atë që keni thënë.
- Liria e një personi duhet të arrijë deri aty sa që mos të shkelë lirinë e të tjerëve.
- Nëse ti bën një gabim, pranoje atë. Nëse nuk e pranon, sapo bërë një të dytë.
- Arsyja se pse njerëzit ta marrin mirësinë për dobësi, është se ti je duke i'u dhënë shumë, më shumë seç meritonjë.
- Gabimi më i madh për ne, është të pranojmë një gabim që nuk e kemi bërë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

19	1	A	18	P	7	E	13	2		19	4	11	16	1	
1	6	1		15	7	9	12	2	12	2				11	
3	2		10	7	6	2	4	11	2	16	1				
7		12	4	11	7	6	13	7		3	3	18			
6	7	2		11	2	2		4		1	6	3			
		18	1	6	1	11	1			1	3	4			
18			7			1	16	2	8	4	13	1			
6	1	5	3	7		11	7	13	2	6	4				
4	8	7		8	7		5	3	7		3	3			
19		15	2	7	13	1		7	13	3		4			
1	6	2	1	13	7	3		6		6	1	18			
3	7	6	6	2	3	4	6		11	7	3	2			
A	Z	O	V	E	T	N	A						B	A	
Z	A	G	A	R		R	A			M	B	A	S		
I	C		K	A	L	I		N	I	O	B	I			
L		C	A	S	U	S	B	E	L	L	I				
			T	E	N	T	A	I	V	A	T		V		
M	A	R	T	I	N	A		E	N		K	E			
E	T	E		S	E	N		R	O	M	A	N			
T	I	M	E		T	I	P	I		A	F	E			
A	M	O	R	F		R	A		T	A	R				
L	O	N		Z	E	T	A		F	A	Z	A			
E	R	I	C		C	E		V	O	N	E				
T	E	A	M		A	L	B	A	N	E	T				

